

Biografia e dietarit të madh të Jemenit

Mukbil ibn Hadi el-Uadi'ij

(Allahu e mëshiroftë!)



Fjalë të Arta:

Ebu Temijm es-Sikhtijani ka thënë:

*“Kur vdes ndonjë njeri i Sunetit në Lindje apo në Perëndim,
më duket sikur më humbet një pjesë e trupit im!”*

Përmbajtja:

- Autobiografi :
- Studimet dhe mësuesit e mi :
- Akideja dhe da'ueti i Shejkh Mukbilit :
- Personaliteti dhe karakteri i Shejkh Mukbilit :
- Studentët e Shejkh Mukbilit :
- Veprat që la pas Shejkh Mukbili :
- Fjalët e paharrueshme të Shejkh Mukbilit :
- Vdekja e tij :
- Fjalët e Ulemave për Shejkh Mukbilin :
- Me të vërtetë Imani dhe Urtësia vijnë nga Jemeni :
- Epilog :

Autobiografi:



Unë vij nga Uadi'a, një vend në lindje të qytetit Sa'dah në luginën e Demaxhit. Emri im është Mukbil bin Hadi bin Mukbil bin Ka'ide el-Hamdani el-Uadi'i el-Khal-lali, nga fisi Ali-Rashid.¹

Lavdërimi i takon Allahut që pjesa më e madhe e popullit të Uadi'as të cilët janë fqinj me Sa'dan më kanë mbrojtur mua dhe Dauetin. Disa prej tyre duan të mbrojnë Fenë kurse të tjerët duan të mbrojnë përkushtimin e tyre fisnor. Sikur të mos ishte Allahu në rradhë të parë dhe pastaj ata (që më ndihmuan), atëherë armiqtë e Dauetit (Selefi), veçanërisht Shijat e Sa'das, nuk do të kishin lënë asnjë shenjë apo gjurmë të tonën.

Do të përmend disa raste rreth tyre, për të cilët unë i lutem Allahut që t'ua shpërblejë. Një nga ato raste ishte kur u përballa me një kundërshtim të ashpër në Xhaminë Hadij sepse i largova njerëzit nga Daueti (i Shijave) aty. Kështu që disa burra nga Uadi'a e të tjerë më qëndruan afër deri sa Allahu më shpëtoi nëpërmjet duarve të tyre. Shijat deshën që të më drejtonin (në rrugën e tyre). Kjo ka qenë gjatë kohës së Ibrahim el-Hamdit, kur njerëz të këqinj nga Komunistët dhe Shijat i ngritën kokat lart dhe më burgosën për një periudhë njëmbëdhjetë ditore gjatë muajit të Ramadanit. Rreth dymbëdhjetë të rinj nga Uadi'a vinin e më vizitonin në burg gjatë netëve, ndërsa njëqind e pesëmbëdhjetë të tjerë nga njerëzit e tyre shkonin tek gardianët e burgut gjatë këtyre netëve aq shpesh sa që këtyre u erdhi në majë të hundës dhe më liruan nga burgu, lavdi Allahut.

Një rast tjetër ishte kur armiqtë e Dauetit vinin ndonjëherë në Demaxh të armatosur, por ata zmbrapseshin nga populli i Demaxhit dhe detyroheshin që të largoheshin të poshtëruar.

¹ E bija e tij, Umm 'Abdullah el-Uadij'a, ka thënë në librin e saj *Nubdha Mukhtesira*, (fq. 18): "Babai i vdiq kur ai ishte ende i vogël dhe nuk e njohu atë, kështu që ai u rrit jetim nën kujdesin e të ëmës për një periudhë kohore. Ajo i kërkonte atij që të punonte për të fituar para dhe e detyronte që të ndiqte shembullin e shoqërisë që të bëhej si ata. Por ai qëndroi larg kësaj dhe thoshte: "Do të shkoj të studioj." Kurse ajo ia kthente: "Allahu të udhëzoftë." Ajo lutej që ai të udhëzohej, sikurse më kanë transmetuar disa gra që kanë qenë në atë kohë. Ndoshta lutja e saj rastisi në kohën kur pranohen duatë sepse ai u bë një nga njerëzit e udhëzuar që i udhëzon të tjerët."

Një rast tjetër ishte gjatë udhëtimeve tona. Kur unë thoja: “Duam që të udhëtojmë”, ata garonin me njëri-tjetrin - Allahu i ruajt - se kush do të më shoqëronte e të më mbronte. Kështu që shpesh herë dilnim në disa nga udhëtimet tona me gati pesëmbëdhjetë makina!

Gjatë këtyre ditëve Daueti po përparon në një mënyrë madhështore sepse lavdi Allahut unë jam më i vjetër në moshë. Ndoshta në këtë çast e kam arritur moshën gjashtëdhjetë e dy vjeçare. Pra, ishin fatkeqësitë që pësua dhe këshillat e atyre që e duan këtë Dauet që më shtynë të jem i butë dhe të mos merrem me armiqte, të cilët nuk dinë gjë tjetër veç të shajnë e të shpifin.

Gjithashtu, për shkak të mësimave të mia, shkrimeve dhe Daues, nuk kam qenë i aftë të gjej kohë për t'u marrë me këta armiq. Kështu që, le të thonë ata çfarë të duan sepse gjynahet e mia janë të shumta dhe mbase për shkak të përgojimeve të tyre do të më pakësohen gjynahet e do bien mbi shpatullat e tyre.

Studimet dhe Mësuesit e mi:



Kam studiuar në shkollë deri sa kam marrë deftesën. Pastaj më kaloi një kohë e gjatë pa kërkuar dije sepse nuk kishte njeri që të më inkurajonte apo të më ndihmonte në kërkimin e dijes. Unë e doja kërkimin e dijes. Kështu që kërkoja ndihmë nga Xhamia Hadij por askush nuk më ndihmoi.

Pas ca kohësh e lashë vendin tim (Jemenin) dhe shkova në tokat e shenjta (Mekke dhe Medine) dhe në Nexhd. Aty dëgjoja ligjëruesit dhe mbeta i mahnitur nga hytbet e tyre. Kështu, u këshillova me disa ligjërues rreth librave të dobishëm që duhet të blija. Ata më këshilluan të merrja *Sahijhul-Bukhari*, *Bulugul-Meram*, *Rijadus-Salibijn* dhe *Fet'hul-Mexhijid* - shpjegimi i librit *Kitabut-Teuhid* - dhe më dhanë kopje të teksteve të kursit të Teuhidit.

Atëkohë punoja si roje sigurimi në një ndërtesë në Meke, kështu që isha shumë i lidhur pas atyre librave. Përmbajtja e atyre librave më ngulitej në mendje sepse ajo që bënin njerëzit në vendin tonë ishte e kundërta e asaj që gjendej tek këta libra, e në mënyrë të veçantë tek *Fet'hul-Mexhijid* (që është shpjegimi i librit *Kitabut-Teuhid*). Pasi kishte kaluar njëfarë kohe, u ktheva në vendin tim dhe fillova të kundërshtoj çdo gjë që pashë se binte në kundërshtim me atë që gjendej tek këto libra, siç ishte prerja e kurbanit për të tjerë në vend të Allahut, ndërtimi i tyrbeve (faltoreve) mbi varre dhe lutja drejtuarit të vdekurit. Kështu që këto lajme mbërritën tek Shijat dhe ata filluan ta flisnin kundër rrugës që ndiqja unë. Njëri prej tyre thoshte: “*Kushdo që ndryshon fenë e tij vriteni.*” Dikush tjetër u dërgoi një letër farefisit tim duke u thënë: “Nëse nuk e ndaloni, ne do ta burgosim!” Por pas gjithë kësaj ata ranë dakort që të më lejonin të hyja në Xhaminë Hadij me qëllim që të studioja me ata. Kështu, ndoshta ata mund t'i largonin keqkuptimet që kishin hedhur rrënjë në zemrën time.

Kështu, më pranuan që të studioja me ta në Xhaminë Hadij. Drejtor atje ishte gjykatësi Mutahir Hanash. Studiova librin *el-'Akduth-Themijn* dhe *eth-Thelathijn Mes'ele*, bashkë me shpjegimin e Habisit. Nga mësuesit që më mësuan atje ishte Muhamed bin Hasen el-Mumtejiz. Një herë po diskutonim çështjen e shikimit të Allahut në Ahiret dhe ai filloi të tallej e të përbuzte Ibn Khuzejmen dhe Imamët e tjerë të Ehli-Sunetit, por unë e mbaja të fshehtë Akiden time.

Megjithëkëtë, unë e kisha të pamundur që ta vendosja dorën e djathtë mbi dorën e majtë në namaz dhe falesha duke i mbajtur duart anash.

Studioam tekstin e Ez'herit deri tek kapitulli i Martesës.

Studiova gjithashtu një shpjegim rreth Ligjeve të Trashëgimisë nga një libër me shumë vëllime i cili ishte jashtë nivelit normal, por nuk është se përfitova kush e di se çfarë prej tij. E pashë se librat që kishin caktuar nuk ishin të dobishëm përveç Gramatikës sepse studiova me ta librat *el-Axbrumije*² dhe *Katarun-Neda*³. Pastaj i kërkova gjykatësit Kasim bin Jahja esh-Shuwel që të më mësonte *Bulugul-Meram*. E filluam atë, por kur nuk ramë dakort e lamë.

Kur e pashë se librat që kishin caktuar (për mësim) ishin të natyrës Shi'ite dhe Mutezilitë, vendosa që të merrija vetëm nga librat e Gramatikës. E kam studiuar *Katarun-Neda* disa herë⁴ në xhaminë ku jetoja dhe falesha me Isma'il el-Hatba, Allahu e mëshiroftë. Ai na kushtonte kohë dhe vëmendje të madhe. Një herë, Muhamed bin Huriya erdhi në xhami dhe unë e këshillova atë që të hiqte dorë nga astrologjia (*tenxhijm*), ndërsa ai u tha njerëzve që të më përjashtonin nga mësimi, por ata ndërhyjnë për mua dhe ai e mbylli gojën.

Disa nga Shijat kalonin pranë meje kur isha duke studiuar librin *Katarun-Neda* dhe thonin gjoja edukimi nuk do të më bënte dobi. Por unë heshtja dhe vazhdoja të përfitoja nga librat e Gramatikës. Kam ndenjur kështu⁵ derisa filloi revolucionin në Jemen dhe ne e lamë vendin tonë dhe u vendosëm në Nexhran. Atje studiova me Ebul-Husejn Mexhdu-Dijn el-Mu'ijid dhe përfitova prej tij veçanërisht në Gjuhën Arabe. Qëndrova në Nexhran për një hark kohor dy

² *el-Axbrumije* është një tekst i vjetër rreth gramatikës së gjuhës Arabe, i shkruajtur për studentët fillestarë të gjuhës nga Ebu 'Abdil-lah bin Muhamed bin Muhamed bin Davud es-Senhaxhi (672-723H), i njohur ndryshe si Ibn Axhurrum, Allahu e mëshiroftë.

³ *Katarun-Neda* është shkruar nga Xhemalud-Din 'Abdil-lah bin Jusuf bin Hisham el-Ensari (708-761H), Allahu e mëshiroftë. Ibn Khaldun ka thënë për të: "Ishim në Magrib (Marok) kur dëgjuam për një dijetar të gjuhës Arabe që ndodhej në Misr (Egjipt), i cili njihej si Ibn Hisham, më i ditur në *Nahw* (Gramatikë) sesa Sibeuejhi."

⁴ Umm 'Abdullah, e bija e Shejkh Mukbilit, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Ai, Allahu e mëshiroftë, interesohej shumë këtu në Jemen për studimin e Gramatikës (*en-Nahw*) përpara se të udhëtonte për në Saudi, ku qëndroi për të kërkuar dije, aq sa ai e mësoi të gjithë librin "*Katarun-Neda*" ngaqë e studioi shumë herë. Dhe fakti që mësuesit e tij ishin nga Shijat e devjuar ishte për shkak të pamundësisë për të gjetur mësues të tjerë që t'i jepnin mësim të dobishme."

⁵ Shejkh Mukbil (*rahimebullah*) ka thënë: "Kam qëndruar mes Shijave duke marrë dije për tre vjet, pastaj Allahu më shpëtoi nga ata."

vjeçar. Pastaj kur u sigurova se lufta midis partisë Republikane dhe partisë së Mbretit (në Jemen) ishte për hir të interesave të kësaj dynjaje, vendosa të udhëtoj për në tokat e shenjta (Mekke dhe Medine) dhe në Nexhd. Jetova në Nexhd për një muaj e gjysëm në një shkollë ku mësohej Kur'ani, në krye të së cilës ishte Shejkh Muhamed bin Sinan el-Heda'i. Ai u tregua shumë mikpritës me mua sepse e pa që përfitova nga dija. Ai më këshilloi të qëndroja për pak derisa të më dërgonte në Universitetin Islamik (të Medines). Por atmosfera në Rijad ndryshoi për mua prandaj vendosa të udhëtoja për në Mekke.

Punoja kudo që gjeja punë dhe kërkoja dije gjatë natës duke marrë pjesë në mësimet e Shejkh Jahja bin 'Uthman el-Pakistanit në Tefsirin e Ibn Kethirit, Sahihun e Bukharit dhe Sahihun e Muslimit.

Kam studiuar disa libra dhe aty kam takuar dy Dijetarë të nderuar nga Jemeni:

I pari: Gjykatësi Jahja el-Eshuel. Studiova me të *Subulus-Selam* të San'anit dhe ai më jepte mësim nga çdo lëndë që i kërkoja.

I dyti: Shejkh 'Abdu-Rrazzak esh-Shahidi el-Muhuejti. Ai më mësonte çdo gjë që i kërkoja.

Pastaj u hap instituti mësimor në Mekke dhe mora testin e hyrjes me një grup studentësh dhe kalova lavdi Allahut.

Mësuesit tanë më të shquar ishin: Shejkh 'Abdul-'Aziz es-Subejel. Unë bashkë me një grup studentësh të institutit mësonim gjithashtu librin *Tuhfetus-Sanije* pas Jacisë në Haram me Shejkh 'Abdullah bin Muhamed bin Humejd, Allahu e mëshiroftë. Ai, Allahu e mëshiroftë, jepte shumë pika të dobishme nga Ibn 'Akili (rreth Gramatikës së Arabishtes) dhe shpjegime nga dijetarët e tjerë. Mësimet ishin mbi nivelin e shokëve të mi, kështu që ata filluan të mos merrnin pjesë derisa përfundimisht ai (Shejkh) i dha fund këtij mësimi.

Studiova gjithashtu bashkë me një grup studentësh me Shejkh Muhamed es-Subejel, Allahu e ruajt, lëndën e Ligjeve të Trashëgimisë.

Pasi qëndrova në Institut për ca kohë u largova për të shkuar tek familja ime në Nexhran. Pastaj i mora ata që të jetonin me mua në Mekke. Jetuam atje sëbashku për tërë harkun kohor të studimeve të mia në Institut dhe Haram, kohë e cila zgjati për gjashtë vjet.

Bereqeti i studimit në xhami dihet mjaft mirë. Mos pyet për ambientin miqësor dhe çlodhjen që ndjemë kur ishin në xhami. Me të vërtetë Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë të vërtetën se: “*Nuk ka grup njerëzish që mblidhen bashkë në një nga Shtëpitë e Allahut duke lexuar Librin e Allahut dhe duke e studiuar atë mes veti, përveç se mbi ta zbret qetësia, ata rrethohen nga melaiket dhe i përfshin mëshira e Allahut dhe Ai i përmend tek ata që janë pranë Tij.*”

E kaloja ditën duke studiuar në Institut dhe të gjitha mësimet më ndihmonin në Akijden dhe Fenë time. Pastaj, pas Ikindisë deri në Namazin e Jacisë shkoja në Haram dhe pija nga uji i Zemzemit, për të cilin Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “*Vërtet ky ujë të ngop dhe është shërëm për sëmundjet.*”

Ne dëgjonim ligjërues të ndryshëm që vinin në Mekke nga vende të ndryshme për të bërë Haxhin apo Umren.

Nga mësuesit me të cilët mësuam në Haram midis Akshamit dhe Jacisë ishte Shejkh ‘Abdul-‘Aziz bin Rashid en-Nexhdi, autori i librit “*Tejsirul-Uahjejn fil-Intisar alet-Kur'an ues-Sahibejn*”, që përmban disa gabime të cilat ne nuk pajtohemi me të. Ai, Allahu e mëshiroftë, thoshte: “Hadithet e sakta që janë jashtë dy Përmbledhjet e Sahihëve mund të numërohen me gishtat e njërës dorës.” Kjo thënie e tij më ngeli në mendje që kur më filluan vërejtjet e para për të. Vazhdoi kështu derisa vendosa të shkruaj “*es-Sahibul-Musned mimma lejse fis-Sahibejn*” pas të cilit u binda më tepër për thënien e tij të gabuar, Allahu e mëshiroftë.

Sidoqoftë, ai ishte njeri i Teuhidit, kishte dije të fuqishme në Shkencën e Hadithit dhe ishte i aftë që të dallonte të saktin nga i dobëti dhe të mangëtin nga i pastri për sa i përket hadithit. Ajo që më mahniti ishte se ai i thërriste njerëzit që të hiqnin dorë nga pasimi i verbër (taklidi), deri sa shkroi një broshurë me titull “*et-Tanagitul-Mukana*” (Tagutët e Maskuar). Qeveria dhe disa nga dijetarët e mëdhenj menduan se ai kishte për qëllim ata, kështu që komisioni i dijetarëve të mëdhenj u mblodhën për të diskutuar me të. Ata thanë: “Mos ke për qëllim me këtë libër ne qeverinë?” Ai u përgjigj: “Nëse e ndjeni se keni cilësitë që kam përmendur në libër, atëherë përfshihen edhe ju në të. E nëse e ndjeni që nuk i keni këto cilësi që kam përmendur në libër, atëherë ju nuk përfshihen në të.” Më pas, ky libër u ndalua që të hyjë në Mbretëri (Arabi Saudite). Për këtë më njoftuan.

Një natë atij i kërkuan që të jepte mësim, por ishte vetëm për ta vënë në provë. Kështu, ai filloi mësimin me thënien e Allahut:

اتَّبِعُوا مَا أُنْزِلَ إِلَيْكُم مِّن رَّبِّكُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا مِن دُونِهِ أَوْلِيَاءَ قَلِيلًا مَّا تَذَكَّرُونَ ﴿٢﴾

“Ndiqe atë që të është shpallur nga Zoti yt dhe mos ndiq ata që adhurohen padrejtësisht në vend të Tij. Pak jeni që përkujtoni.”⁶

Pastaj vazhdoi me një numër ajetesh që vërtetonin ndalimin e taklidit. Pas kësaj ai u ndalua nga mësimdhënia në Haram, Allahu na ruajt!⁷

Dhe një nga mësuesit e mi në Xhaminë e Madhe të Mekkes, nga i cili përfitova, ishte Shejkh Muhamed bin ‘Abdil-lah es-Sumali sepse kam marrë pjesë në mësimet e tij për rreth shtatë apo më tepër muaj. Ai ishte një shenjë e qartë në aspektin e dijes rreth transmetuesve të dy Shejkhave (Bukhari dhe Muslimi). Përfitova jashtëzakonisht nga ai në Shkencën e Hadithit. Lavdërimi i takon Allahut që kur fillova të kërkoja dije, nuk kam dashur gjë tjetër përveç dijes së Kur'anit dhe Sunetit.

Pasi përfundova nivelin mesatar dhe dytësor të studimit në Institutin e Mekkes dhe pasi i plotësova të gjitha mësimet e mia fetare, kalova për në Medine që të

⁶ Araf, 3.

⁷ Për njëfarë kohe Shejkh Mukbili e ka kritikuar udhëheqjen e Mbretërisë së Arabisë Saudite për shkak të pakënaqësive që lindën nga ngjarjet e pahijshme që i përjetoi aty. Si përherë kjo gjë i shërbeu shumë propagandës së tekfirsave të cilët i shfrytëzonin fjalët e tij për Dautin e tyre të Tekfirit dhe Khuruxhit (rebelimit) kundër aparatit shtetëror Saudit. Edhe pse Shejkh Mukbili nuk ndante të njëjtin menhexh me Tekfirsat pasi menhexhi i tij ishte Menhexhi Selefij kurse menhexhi i tyre ishte menhexhi i baballarëve të tyre, Menhexhi i Khauarixhëve, Shejkh Mukbili u distancua nga idetë e tij kritikuese ndaj udhëheqjes së Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe u pendua për fjalët që kishte thënë dhe kishte shkruar në librat e tij dhe kërkoj që ato të fshiheshin prej tyre, siç ishte për shembull libri i tij *el-Mekbraxh minel-Fitne*. Gjatë kohës kur ka qenë i shtruar në spital në Xhidde (më 15 të muajit Rabi’ul-Euel, 1422H) ndërkohë që ishte në shtrat, ai u pyet: A i keni tërhequr deklaratat tuaja për të gjitha qeveritë? Ai u përgjigj: “Unë i kam tërhequr deklaratat e mia për qeverinë Saudite, Allahu ua shpërbleftë me të mira. Kurse për qeveritë e tjera, jo.” Pyetësi i tha: Allahu ua shpërbleftë me të mira o Shejkh. Është thënë se ju keni shkruajtur një parathënie për një nga librat e Makdisiut [Isam el-Barkau] në të cilin trajtohet çështja e tekfirit ndaj këtij vendi. A është e vërtetë kjo? Shejkhu ia ktheu: “Kjo është gënjeshtëri, unë isha në Medine dhe pastaj në burg në Medine dhe në Rijad dhe kur dola nuk bëja tekfir ndaj qeverisë, si kështu atëherë mund të bëj tekfir ndaj kësaj (qeverie)? Pejgamberi (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “*Kushdo që i thotë vëllait të tij “O Qafir”, atëherë vërtet kjo do t’i ngelet njërit prej tyre.*” Kështu që nuk na lejohet neve që të bëjmë tekfir ndaj tyre sepse ata janë një shtet Musliman, uallahu muste’an.”

hyja në Universitetin Islamik atje.⁸ Shumë nga ne u transferuan në Fakultetin e Da'ues dhe Usul-Dinit. Nga më të dalluarit që na dhanë mësim atje ishin: Shejkh es-Sejid Muhamed el-Hakim dhe Shejkh Mahmud 'Abdul-Uehab Fa'id, që të dy nga Egjipti. Kur erdhi koha e pushimeve, u frikësova mos do të më kalonte koha kot kështu që u futa në Fakultetin e Sheriatit për dy arsye dhe e para nga këto dy arsye ishte që që përfitoja dije:

Kjo sepse disa orë mësimore atje ishin të përparuara ndërsa të tjerat ishin të përziera. Pra, ishte si njëfarë përsëritjeje të asaj që kisha mësuar në Fakultetin e Da'ues. I përfundova të dyja kurset e Fakultetit - dhe të gjitha falenderimet i takojnë vetëm Allahut - dhe më dhanë dy diploma. Megjithatë, lavdërimi i takon Allahut, mua s'më interesojnë fare diplomat⁹; ajo që meriton vlerësim në opinionin tim është dija.

Po në të njëjtin vit përfundova dy kurset e Fakultetit dhe në Universitetin Islamik doli programi për studimet e përparuara, të cilin ata e quanin programi i Magjistraturës. Kështu që shkova për intervistën që më testuan dhe kalova lavdi Allahut. Kursi i studimeve të përparuara ishte në Shkencën e Hadithit. Lavdi Allahut, studiova lëndën që desha më shumë. Nga më të dalluarit që na mësuan atje ishin: Shejkh Muhamed el-Emin el-Misri, Allahu e mëshiroftë, Shejkh es-Sejid Muhamed el-Hakim el-Misri, dhe gjatë pjesës së fundit të studimit tim, Shejkh Hammad el-Ensari. Për disa netë kam marrë pjesë në mësimet e Shejkh 'Abdul-'Aziz bin Bazit në Xhaminë e Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) (në Medine) në lëndën e Sahihut të Muslimit. Kam marrë pjesë gjithashtu në mexhliset e Shejkhul-Albanit që të veçanta për studentët e dijes, me qëllim që ata të mësonin prej tij.

Gjatë kohës që isha në Mekke u jepja mësim disa studentëve të dijes nga librat *Katarun-Neda* dhe *et-Tuhfetus-Sanije*. Ndërsa kur isha në Medine u mësoja disa vëllezërve librin *et-Tuhfetus-Sanije* në Xhaminë e Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*). Pastaj u premtova vëllezërve se do t'u mësoja *Xhamiun* (*Sunenin*) e Tirmidhiut, *Katarun-Neda* dhe *el-Baithul-Hathijth* në shtëpinë time pas Ikindisë.

⁸ Kur shkoi në Universitetin Islamik të Medines, Shejkh Mukbili, Allahu e mëshiroftë, ishte në moshën 30-të vjeçare.

⁹ Shejkh Mukbil ka thënë: "Sa të shumtë janë ata njerëz me tituj doktrature në Fik'h dhe kur vjen puna s'kuptojnë asgjë; sa të shumtë janë ata njerëz me tituj doktrature në Hadith dhe kur vjen puna nuk kuptojnë asnjë hadith, ngase këto diploma i ngrejnë lart shumë njerëz që ata të arrijnë poste të larta, të cilat ata nuk i meritojnë. E si mund të të ndihmojnë këto tituj të doktoraturës kur ju jeni injorantë rreth Sheriatit të Allahut?"

Shejkh Salih el-Feuzan thotë: "Nuk është çështja që të kesh deftesa apo diploma, por çështja është që të kesh dituri dhe kuptimin e vërtetë të saj."

Një valë e madhe Daueti u përhap nga Medineja e cila përfshiu të gjithë botën brenda një harku kohor prej gjashtë vjetësh. Ishin disa njerëz të mirë të cilët morën përsipër detyrën e financimit të tij (të Dauetit) ndërsa Mukbil bin Hadi dhe vëllezërit e tij ishin nga ata që morën përsipër detyrën e mësimin të vëllezërve të tyre. Kurse për sa i përket udhëtimeve për të thirrur për tek Allahu në të gjitha krahinat e Mbretërisë, kjo ishte marrë përsipër nga të gjithë vëllezërit – studentët e dijes - në mënyrë që ata të merrnin dije për vete dhe që të edhe njerëzit e thjeshtë. Nga kjo nismë përfituan shumë nga njerëzit e thjeshtë dhe atyre iu shtua akoma më tepër dashuria për Da'uetin (Selefi).

Një nga vëllezërit tanë Musliman që ishte nxëjës i dijes ishte Imami i një xhamije në Rijad. Njëherë disa njerëz e qortuan atë për shkak se ai përdori sutre. Kurse ai ua ktheu: “Ne nuk jemi të aftë që të merremi me ju, por pasha Allahun, nuk do të çohet njëri tjetër përveç se një person i thjeshtë i cili do vijë t’ju mësojë hadithet e Sutres.” Kështu, ai thirri një vëlla që ishte njeri i thjeshtë që e donte Dauen dhe i kishte mësuar përmendësh hadithet e Sutres nga “*el-Lu’lu uel-Merxhan fij mateffeka ‘alejhi Shejkhhan*”. Ai u çua dhe i kumtoi këto hadithe, e më pas kundërshtarët u turpëruan dhe e mbyllën gojën.

Pas kësaj, pasuesit e verbër dhe dijetarët e sherrit u vunë në lëvizje. Arsyeja e turbullimit të këtyre pasuesve të verbër të cilët konsideroheshin dijetarë para syve të njerëzve, ishte sepse sa herë që ata hasnin ndonjë nga studentët tanë të rinj, ata përdornin ndonjë hadith si argument, kurse studenti ua kthente: “Kush e ka transmetuar këtë hadith?” Dhe kjo ishte diçka me të cilën ata nuk ishin mësuar. Pastaj ai u thoshte atyre: “Çfarë grade ka ky hadith?” Kjo gjithashtu ishte diçka me të cilën ata nuk ishin mësuar. Pra, ata (studentët e dijes) i vinin ata në siklet përpara njerëzve të tjerë. Dhe ndonjëherë studenti u thoshte atyre: “Ky hadith është i dobët. Në zinxhirin e transmetimit është filani dhe ai është shpallur i dobët nga filan dijetar.” Kështu që pasi e dëgjonin këtë, dukej sikur toka po ngushtohej nën këmbët e këtyre pasuesve të verbër. Pastaj ata nisën të përhapnin shpifje sikur këta ishin Khauarixhë, kur në fakt këta vëllezër nuk ishin nga Khauarixhët të cilët e bëjnë të lejuar derdhjen e gjakut të Muslimanit dhe e konsiderojnë Muslimanin qafir për hesap të gjynaheve.

Megjithatë, ndodhën disa gabime nga ana e disa vëllezërve të rinj dhe kjo ndodhi për shkak se fillestari është gjithmonë i pushtuar nga një entuziazëm i papërmbajtur. Në atë kohë unë po përgatisja tezën time të magistraturës, kur papritur gjatë natës, para se ta merrja vesh se çfarë po ndodhte, ata më arrestuan bashkë me rreth njëqind e pesëdhjetë të tjerë. Disa njerëz qenë të aftë

të shpëtonin por toka u trondit mes atyre që kundërshtuan dhe atyre që ishin dakort me arrestimin tonë. Qëndruam në burg për një muaj apo një muaj e gjysëm. Më pas na liruan, lavdi Allahut.

Shumë pak kohë pas kësaj, dolën broshurat e Xhuhejmanit¹⁰ dhe një grup prej nesh u arrestua sërish. Gjatë hetimit më pyetën: “Ti je ai që i ke shkruajtur këto?” (U thashë:) “Çfarë, Xhuhejmani nuk di të shkruajë?” Kështu që e mohova këtë - dhe Allahu e di që unë nuk i kam shkruajtur ato dhe as nuk kam ndihmuar në ndonjërin prej tyre. Por pasi qëndruam në burg për tre muaj, doli urdhëri që të huajt të dëboheshin nga vendi.

Kur arrita në Jemen¹¹ u ktheva në fshatin tim dhe qëndrova atje pak kohë duke mësuar fëmijëve Kur'an. Pa e marrë vesh akoma më dukej sikur e gjithë bota ishte në luftë me mua. Dukej sikur kisha ardhur për të shkatërruar vendin, Fenë dhe udhëheqjen. Në atë kohë nuk njihja asnjë udhëheqës apo kryetar fisesh. Kështu që thoja: “Më mjafton Allahu dhe Ai është Mbrojtësi më i mirë.” Kur më shkonin punë keq, shkoja në San'a, Hashid, Dhimar, Ta'iz, Ibb dhe Hudejde për të bërë Daue dhe për të vizituar vëllezërit Muslimanë.

Pas ca ditësh, disa njerëz të mirë më dërguan bibliotekën time nga Medina. Ata i dërguan librat në Sa'da ku drejtor i doganës aty ishte një armik i Sunetit. Disa nga shokët tanë shkuan për të kërkuar librat nga ai dhe ai ua ktheu: “Hajdeni pas Drekës InshaAllah.” Por ai nuk u kthye pas Drekës. Ndërkohë, disa nga Shijat u ngritën dhe i kërkuar përgjegjësit që t'i konfiskonte librat sepse ata ishin libra “Uhabistë”!

¹⁰ Ky ishte Xhuhejman bin Muhamed el-'Utejbi, një person i devijuar nga Arabia Saudite që pushtoi Xhaminë e Madhe në Mekke me disa qindra pasues të tij në vitin 1979 dhe e mbajti të pushtuar për disa ditë me rradhë, ku më pas dijetarët e mëdhenj e lejuan përdorimin e forcës përreth territorit të shenjtë të Qabes me qëllim rimarrjen e saj. Truproja Kombëtare Saudite i mposhti ata rreth dy javë më pas dhe aty u derdh shumë gjak dhe pati viktima nga të dyja palët. Rebelët që shpëtuan u kapën dhe u ekzekutuan me prejre të kokës. Shejkhul-Albani, Allahu e mëshiroftë, e ka përmendur Xhuhejmanin në librin e tij *es-Sahijha* (5/872) ku thotë: “...si puna e pasuesve të Xhuhejmanit, Sauditi i cili qe shkaktar i fitnes në Xhaminë e Madhe në Mekke në fillim të vitit 1400 (Hixhri). Ai pretendoi se Mehdiu i shumëpritur ishte me të dhe u kërkoj të pranishmëve në Xhami që t'i jepnin besën atij. Disa njerëz mendjelehtë, të pandërgjegjshëm e të këqinj e pasuan atë. Pastaj Allahu i dha fund fitnes së tyre pasi që ata kishin derdhur shumë nga gjaku i Muslimanëve.” Është fatkeqësi akoma më e madhe kur shikon sot të rinj në trojet shqiptare që simpatizojnë ende Xhuhejmanin dhe ata që janë si puna e tij! Ata të gjojnë nuk e kuptojnë se janë viktima të ideologjisë shkatërrimtare të Khahaurixhëve. Allahu i drejtoftë zemrat e tyre dhe u dhëntë kuptimin e drejtë të Fesë!

¹¹ Shejkh Mukbili, Allahu e mëshiroftë, ka qenë rreth 40 vjeç kur u kthye nga Arabia Saudite. Kurse e gjithë koha që kaloi në Arabinë Saudite në kërkimin e dijes ishte 15 vjet.

Mos pyet për tarifat monetare, vështirësitë dhe padrejtësitë që kam hequr gjatë përpjekjes për të marrë librat e mi! Shumë nga vëllezërit që ishin banorë të vendit tim bënë përpjekje të jashtëzakonshme për ta çuar këtë deri në fund, përfshi këtu edhe Shejkh 'Abdullah bin Husejn el-Ahmer, Shejkh Haza' Dab'an, kujdestarët e Qendrës për Udhëzim dhe Këshillim, siç ishte Gjykatësi Jahja el-Fezajel - Allahu e mëshiroftë - dhe vëllai A'id bin 'Ali Mismar. Pas një mundimi të gjatë njerëzit e Sa'das i dërguan një telegraf Presidentit 'Ali bin 'Abdilah bin Salih dhe kështu ai ia ngarkoi çështjen gjykatësit 'Ali es-Seman. Gjykatësi më dërgoi një letër dhe më premtoi se do të ma kthente bibliotekën. Ai tha: "Njerëzit e Sa'das janë shumë të rreptë. Ata i quajnë qafira dijetarët e San'as." Kështu që shkova në San'a për të marrë librat. Allahu kishte caktuar që librat të mbërrinin atje, ndërsa gjykatësi 'Ali Seman ishte jashtë vendit me detyrë, kështu që kur disa nga vëllezërit shkuan për t'i kërkuar, drejtori në Ministrinë e Financave u tha: "Këta libra duhet të kontrollohen." Disa vëllezër Muslimanë të Qendrës për Udhëzim dhe Këshillim u mobilizuan dhe shkuan për të kërkuar librat. Ata thanë: "Këta libra janë nën mbikqyrjen tonë. Ne duhet t'i kontrollojmë dhe kush është i saktë do t'ia dorëzojmë Uadi'ut (Shejkh Mukbili) dhe kush që bie në kundërshtim me Fenë do të ta mbajmë këtu." Duke vepruar kështu ata morën vesh se librat në fakt ishin të pastër nga ana fetare dhe m'i kthyen pa i kontrolluar, kështu që Allahu ua shpërbleftë.

I solla librat në vendin tim - lavdi Allahut - dhe të afërmit e mi, Allahu ua shpërbleftë, ndërtuan një bibliotekë dhe një xhami të vogël dhe thanë: "Ne do ta falim Xhumanë këtu për të mënjeluar vështirësitë dhe problemet." Ndonjëherë faleshim atje vetëm me gjashtë njerëz të pranishëm.

Njëherë më kërkoi guvernatori Hadi el-Hashishi, kështu që shkova tek Shejkh Ka'id Mexhli, Allahu e mëshiroftë, i cili më pas e thirri atë dhe i tha: "Çfarë do nga el-Uadi'i (Shejkh Mukbili)? Ai tha: "Asgjë, veç dua ta njoh." Kështu ai i tha: "Do ta takojmë atë në institutin e tij."

Në një rast tjetër, një tjetër pushtetar më kërkoi dhe kështu Husejn bin Ka'id Mexhli erdhi me mua që ta takonim. Ai (Mexhli) filloi të fliste kundër Shijave dhe i shpjegoi atij se ne thërrasim për tek Kur'ani dhe Suneti dhe se Shijat na urrejnë për këtë arsye dhe sepse ata kanë frikë se mos del në shesh e vërteta e tyre. Kështu, ky pushtetar tha: "Me të vërtetë, Shijat e kanë njollosur historinë e Jemenit, prandaj për sa kohë që Daueti juaj është i tillë sikurse thoni ju, atëherë thërrisni (për tek Kur'ani dhe Suneti) dhe ne jemi me ju."

Pas kësaj kalova një pjesë të kohës në bibliotekën time. Vetëm pak ditë kishin kaluar kur erdhën disa vëllezër Egjiptianë dhe filluam të mësonim disa nga librat e Hadithit dhe Gjuhës Arabe. Pastaj studentët filluan të vinin nga Egjipti, Kuvajti, Tokat e Shenjta (Meka dhe Medineja), Nexhdi, Adeni, Hadrameuti, Algjeria, Libia, Somalia, Belgjika dhe nga vende të tjera Muslimane dhe jo-Muslimane.

Numri i studentëve tashmë ka arritur rreth gjashtëqind deri në shtatëqind, mes të cilëve ka dhe njëqind e shtatëdhjetë familje. Dhe Allahu është Ai që u siguron atyre furnizim.¹² Dhe e gjitha kjo nuk është si rezultat i fuqisë apo pushtetit tonë dhe as nga sasia e dijes që kemi ose si rezultat i kurajos dhe elokuencës në të folur. Por kjo është diçka që Allahu dëshiroi të jetë kështu. Pra, Ai ishte i Vetmi dhe të gjitha falenderimet i takojnë vetëm Allahut që na dha këtë begati.”

¹² Këto fjalë i ka thënë Shejku rreth vitit 1999. Që atëherë e deri në ditët e sotshme numri i studentëve që studiojnë në Institut ka arritur në rreth njëmijë dhe numri i familjeve të vendosura aty rreth pesëqind. Instituti *Darul-Hadijth* në Demaxh u themelua rreth vitit 1399 Hixhrij, nga Shejkh Mukbili, Allahu e mëshiroftë dhe ia ndriçoftë fytyrën! Pas vdekjes së tij, Institutin e drejton një nga studentët e tij më të afërt, Shejkh Jahja el-Haxhuri. Vlen të theksohet fakti se ky Institut u ndërtua fillimisht me baltë, në tokën e cila ishte pronë e Shejkhut. Kurse tani ai është zgjeruar tej mase dhe aty jepet mësim Kur’ani, Hadithi dhe shkenca të tjera të Islamit pa pushim, natën dhe ditën, qoftë për meshkujt ashtu edhe për femrat, si dhe shërben njëkohësisht si strehë për studentët e dijes. Ndërsa ata që janë të shoqëruar nga gratë e tyre kanë patur mundësinë që të ndërtonin shtëpitë e tyre në tokën e Shejkhut i cili e dhuroi atë si uakëf për Dauetin.

Akideja dhe Da'ueti i Shejkh Mukbilit:



Këto janë disa nga pikat ku mbështetej daueti i Shejkh Mukbilit, të cilat përmbledhin Akiden dhe Menhexhin e tij, Allahu e mëshiroftë:

[1]: “Ne e besojmë Allahun me Emrat dhe Cilësitë e Tij ashtu siç janë përmendur në Librin e Allahut dhe në Sunetin e të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) pa i shtrembëruar ato (*tabrif*), pa u dhënë shpjegim figurativ (*te’uijl*), pa i shembëlluar (*temthil*), pa u bërë përngjasim (*teshbijh*) dhe pa i mohuar ato (*te’til*).

[2]: Ne besojmë se lutja dhe kërkimi i ndihmës qoftë nga të vdekurit apo edhe nga të gjallët - për të cilën ata nuk kanë kurrfarë mundësie - në vend të Allahut, është Shirk ndaj Allahut. Poashtu, edhe besimi se hajmalitë dhe nuskat mund të të bëjnë dobi me apo pa Allahun është Shirk dhe mbajtja e tyre pa patur këtë besim është supersticion.

[3]: Ne e marrim Kur'anin dhe Sunetin sipas kuptimeve të dukshme të tyre dhe nuk u bëjmë shpjegim figurativ (*te’uijl*) përveç kur kemi një argument që kërkon shpjegim figurativ të Librit dhe Sunetit.

[4]: Ne besojmë se Besimtarët do ta shohin Zotin e tyre në Ditën e Gjykimit dhe nuk hetojmë në mënyrën se si do të ndodhë kjo. Ne besojmë gjithashtu në Shefatin (Ndërmjetësimin në Ditën e Gjykimit) dhe besojmë se njerëzit e Teuhidit do të dalin nga Zjarri (i Xhehenemit).

[5]: Ne i duam Sahabët (*radij-Allahu ‘anhum*) e të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) dhe i urrejmë ata që flasin kundër atyre. Ne besojmë se të flasësh keq kundër atyre është të flasësh keq kundër Fesë sepse ata janë që e përcollën Fenë deri tek ne. Ne e duam Familjen e Pejgamberit (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) me dashurinë që ka ligjëruar Sheriati.

[6]: Ne i duam Dijetarët e Hadithit dhe të gjithë të Parët e këtij Umeti që janë nga Pasuesit e Sunetit.

[7]: Ne e hedhim poshtë dijen e *ilmul-kelamit* (retorikën e filozofinë) dhe e konsiderojmë atë si një nga arsyet më madhore për përçarjen e Umetit.

[8]: Ne nuk pranojmë asgjë nga librat e *fik'hut* (jurisprudencës Islame), as nga librat e *tefsirit* (shpjegimit të Kur'anit), as nga librat e historive të mëherëshme, as nga historia e Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*), përveç asaj që është konfirmuar nga Allahu dhe i Dërguari i Tij (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*). Ne nuk themi që i hedhim poshtë ato dhe as nuk pretendojmë se nuk kemi nevojë për to. Përkundrazi, ne përfitojmë nga arritjet dhe zbulimet e Dijetarëve dhe juristëve tanë dhe të tjerëve. Megjithatë, ne nuk e pranojmë një gjykim përveç se me argument të vërtetë.

[9]: Ne nuk e shkruajmë asnjë libër, as nuk mbajmë leksione dhe hytbe me asgjë tjetër përveç se me Kur'an dhe me hadithin e saktë dhe të besueshëm. Ne e urrejmë atë që del nga shumë libra dhe ligjërues siç janë historitë false dhe hadithet e dobëta e të shpikura.

[10]: Ne nuk bëjmë tekfir mbi asnjë Musliman për shkak të ndonjë gjynahu, përveç të bërit Shirk Allahut dhe lënien e Namazit ose braktisjen e Fesë. Allahu na ruajt nga këto.

[11]: Ne besojmë se Kur'ani është Fjala e Allahut dhe nuk është i krijuar.

[12]: Ne e konsiderojmë obligim bashkëpunimin mbi të Vëretën me çdo Musliman dhe i pastrojmë vetet tona para Allahut duke u distancuar nga thirrjet e Xhahilijetit.

[13]: Ne e konsiderojmë të pasaktë rebelimin kundër prijësave të Muslimanëve për sa kohë që ata janë Muslimanë dhe nuk mendojmë se revolucionet mund të sjellin përmirësimin e tyre. Përkundrazi ato e prishin shoqërinë. Sa për udhëheqësit e Adenit, ne mendojmë se luftimi i tyre është obligim derisa ata të pendohen nga Ateizmi, Socializmi dhe thirrja për adhurimin e Leninit dhe Marksit e të tjerëve, të cilët kanë shpallur haptazi kufrin.

[14]: Ne besojmë se kjo mori partish dhe grupesh në ditët e sotshme është një nga arsyet për përçarjen dhe dobësinë e Muslimanëve.

[15]: Ne besojmë se Daueti i Ikhuatul-Muslimin nuk është Dauet i drejtë e i saktë i cili mund të sjellë përmirësimin e shoqërisë. Në të vërtetë Daueti i tyre

është politik e jo fetar. Poashtu, ai është dauet i Bidatit sepse ai është një dauet i cili thur miqësi të panjohur (jo në bazat e Kur'anit dhe Sunetit) dhe është dauet i fitneve që është ngritur mbi bidate.

[16]: Ne i këshillojmë vëllezërit që punojnë mes rradhëve të tyre që t'i braktisin ata (Ikhuatul-Muslimin), derisa të mos e harxhojnë më kohën e tyre me ato gjëra që nuk i bëjnë dobi Islamit dhe Muslimanëve. Dhe është detyrë për çdo Musliman që t'i japë përparësi Allahut dhe ndihmesës së Islamit dhe Muslimanëve me dorën e çdo Muslimani, çfarëdo xhemati që i përket ai.

[17]: Ne e kufizojmë kuptimin tonë të Librit të Allahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) tek kuptimi i Dijetarëve të Hadithit nga Selefët e këtij Umeti e jo tek pasuesit e tyre të verbër. Më saktë, ne e marrim të vërtetën kudo që na vjen ajo. Dhe ne e dimë se ka nga ata që pretendojnë Selefizmin por sidoqoftë Selefizmi është i pastër nga ata, sepse ata i sjellin shoqërisë atë që Allahu e ka ndaluar.

[18]: Ne besojmë se politika është pjesë e Fesë dhe ata që përpiqen ta ndajnë Fenë nga politika përpiqen vetëm që ta shkatërrojnë Fenë e të përhapin kaos. Poashtu, ajo që është përhapur në disa nga shtetet Islame se "Feja është për Allahun kurse shteti është për popullin" është një thirrje e Xhahilijetit. Por, çdo gjë duhet të jetë për Allahun.

[19]: Ne besojmë se nuk do të ketë nder dhe ngadhënjim për Muslimanët derisa ata t'i kthehen Librit të Allahut dhe Sunetit të Pejgamberit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*).

[20]: Ne i urrejmë partitë e sotshme: Partitë e kufrit si Komunizmi, Ba'athizmi, Nasirizmi, Socializmi dhe Rafidizmi. Ne besojmë se të gjithë njerëzit janë të ndarë në dy parti: partia e Allahut, të cilët janë ata që zbatojnë shtyllat e Islamit dhe shtyllat e Imanit; dhe partia e Shejtanit, të cilët janë ata që i kanë shpallur luftë Sheriatit të Allahut.

[21]: Ne i kundërshtojmë ata që e ndajnë Fenë në çështje të rëndësishme dhe çështje të parëndësishme dhe e dimë se ky është një dauet shkatërrimtar.

[22]: Ne i kundërshtojmë ata që e hedhin poshtë dijen e Sunetit me pretendimin se sot nuk është koha për të. Poashtu, ne i kundërshtojmë ata që e hedhin poshtë veprimin sipas Sunetit të Pejgamberit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*).

[23]: Ne besojmë se çështjeve më të rëndësishme duhet t'u jepet përparësi mbi çështjet e tjera. Prandaj, është e rëndësishme që Muslimanët t'i japin rëndësi Akijdes dhe t'i ndalojnë përpjekjet e partisë Komuniste e Ba'thiste. Dhe kjo nuk mund të ndodhë vetëm se duke u kapur fort pas Librit dhe Sunetit.

[24]: Ne besojmë se asnjë Xhemat nuk ka aftësi për t'u përballur me armiqtë, qofshin ata Rafidij, Shi'a, Sufij apo Sunij; derisa ata të kenë vëllazëri të vërtetë dhe të jenë të bashkuar në këtë Akijde.

[25]: Ne i kundërshtojmë ata që janë arrogantë e që pretendojnë se ata që thërrasin për tek Allahu janë agjentë Uehabista. Ne e dimë se qëllimi i tyre i poshtër është pengimi i njerëzve të thjeshtë nga njerëzit e dijes.

[26]: Daueti dhe Akideja që kemi janë më të dashura për ne sesa vetet tona, pasuria dhe fëmijët tanë. Kështu që ne s'jemi përgatitur për t'i shitur as me ar e as me argjend. E themi këtë me qëllim që askush të mos shpresojë se do ta blejë Dauetin tonë, të mos mendojë se mund ta blejë atë me dinarë apo me dirhemë, sepse politikanët e dinë tashmë këtë gjë për ne dhe ata i kanë humbur shpresat se mund të na i blejnë (da'uetin) duke na ofruar pozitë apo pasuri.

[27]: Ne i duam qeveritë sipas mirësisë që kanë ato dhe i urrejmë ato për sherrin (të keqen) që kanë ato. Ne nuk e lejojmë rebelimin kundër atyre, përveç kur të kemi parë kufër (mosbesim) të qartë nga ana e tyre, për të cilin kemi argument nga Allahu, me kusht që ne të jemi të aftë për ta bërë atë (rebelimin kundër qeverisë) dhe që të mos ketë luftë civile mes Muslimanëve dhe kundërshtarëve të tyre, pasi qeveritarët i përshkruajnë ata që rebelohen kundër tyre si spiunë që shkaktojnë ç'rregullim. Dhe pas kësaj vijnë kushtet të tjera, prandaj referoju librave të tjerë që kemi. Më e keqja nga të gjitha qeveritë e tjera është qeveria Komuniste e Adenit. Allahu e shpejtoftë rrëzimin e saj dhe i pastroftë tokat Islame nga ai (komunizmi).

[28]: Ne e pranojmë udhëzimin dhe këshillën nga kushdo që na vjen dhe ne e dimë që jemi nxënësa të dijes: herë jemi të saktë e herë të tjera gabojmë, herë jemi të ditur e herë injorantë.

[29]: Ne i duam dijetarët e Sunetit në kohën e sotme dhe shpresojmë që të përfitojmë nga ata dhe na vjen shumë keq për largimin e shumë prej tyre.

[30]: Ne nuk e pranojmë fetvanë përveç kur ajo është nga Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*).

[31]: Ne i kundërshtojmë ata që vizitojnë varret dhe ata që i lavdërojnë fjalët e kufrit.

[32]: Ne i kundërshtojmë udhëheqësit Muslimanë për bashkimin që ata kanë me armqitë e Islamit, qofshin ata Amerikanët apo Komunistët.

[33]: Ne i kundërshtojmë thirrjet e Xhahilijetit si, nacionalizmi dhe pan-Arabizmi (nacionalizmi i popullit Arab). Ne i kundërshtojmë ato dhe i quajmë thirrje të Xhahilijetit dhe mendojmë se ato janë shkaku i rënies së Muslimanëve.

[34]: Ne jemi në pritje të muxhedidit me të cilin Allahu do ta ringjallë këtë Fe. Ebu Davudi ka transmetuar në Sunenin e tij nga Ebu Hurejra (*radij-Allahu 'anh*) nga Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) i cili ka thënë: “Vërtet, Allahu dërgon në krye të çdo shekulli një muxhedid për këtë Umet që ta ringjallë Fenë.”¹³ Ne besojmë gjithashtu se ai do të sjellë rizgimin Islamik që do të përhapet gjithandej.

[35]: Ne besojmë fuqimisht në devijimin e atij që refuzon hadithet që flasin për Mehdiun, Dexhalin dhe për zbritjen e Isait, të birit të Merjemes, *alejhis-selam*. Ne nuk e kemi fjalën për Mehdiun e Rafidave, por e kemi fjalën për prijësin që është nga Familja e Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*), nga Ehli-Suneti, i cili do ta mbushë tokën me drejtësi dhe mirësi, ashtu siç ishte mbushur me padrejtësi përpara ardhjes së tij. Ne themi gjithashtu se ai është nga Ehli-Suneti, ngase sharja e Sahabëve të nderuar nuk është drejtësi.

¹³ **Sahih:** transmetuar nga Ebu Davudi (n. 4291), Hakimi (4/522) el-Khatib el-Bagdadi në *Tarikh Bagdad* (92/61), Ibn 'Adij në *el-Kamil* (1/123), Bejhakui në *Ma'rifetus-Sunen uel-Ether* (1/137). Është saktësuar nga Imam Ahmedi, siç gjendet në *Sijer A'lamun-Nubela* (10/46) dhe nga Hakimi, siç gjendet në *Fejdul-Kadir* (2/282). Me të vërtetë Imam Shemsul-Hak el-'Adhimebadi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë në *'Aunul-Ma'bud* (11/385): “Dhe ajo çfarë nënkuptohet me ringjallje janë veprat e zhdukura nga Libri dhe Suneti dhe urdhërimi sipas tyre,” dhe ai tha gjithashtu: “...dhe ai muxhedid nuk do të njihet përveç se nga opinioni i shumicës së Dijetarëve që jetojnë në kohën e tij – për shkak të gjendjes së tij dhe dobive që burojnë nga dija e tij – ngase muxhedidi duhet të zotërojë dije rreth degëve të Fesë, të asaj që është e qartë dhe asaj që është e paqartë, të ndihmojë Sunetin (*nasirun lis-Sunneh*), të largojë bidatin dhe që dija e tij të njihet nga njerëzit e kohës së tij...” dhe ai (Imam Shemsul-Hak) vazhdoi: “Pra, është e qartë se muxhedidi nuk ka për të qenë askush tjetër përveç se një dijetar i degëve të dijes së fesë dhe që ai të përpiqet dhe t'i kushtojë vëmendje të madhe natë e ditë ringjalljes së çështjeve të Fesë dhe përhapjen e saj, t'i ndihmojë njerëzit e saj, t'i luftojë çështjet e reja që janë shpikur dhe t'i heqë ato, t'i drejtojë njerëzit me gjuhën e tij ose duke shkruajtur librat ose duke dhënë mësim, e kështu me rradhë – dhe ai që nuk është i këtillë nuk mund të jetë në asnjë mënyrë muxhedid – edhe nëse ai është një dijetar i shkencave Fetare, i famshëm mes njerëzve dhe i kërkuar prej tyre...”

[36]: Kjo është shkurtimisht Akideja dhe Daueti ynë, të cilat po t'i përmendim bashkë me argumentet përkatëse do ta zgjasnin librin. Unë i kam përmendur argumentet e tyre në librin *el-Mekhraxh minel-Fitne*. Dhe nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth saj, atëherë ne jemi të gatshëm që ta pranojmë këshillën nëse ajo është e vërtetë, ta refuzojmë nëse është e gabuar dhe ta hedhim pas shpine nëse është refuzim kryeneç. Dhe Allahu e di më së miri.

Kështu që le të merret vesh se kjo nuk përfshin të gjithë Dauen dhe Akiden tonë sepse daueti ynë është nga Libri i Allahut dhe Suneti, është për Kur'anin dhe Sunetin dhe po kështu është edhe Akideja jonë. Allahu na mjafton ne dhe Ai është më i Miri të Cilit mund t'i mbështetesh. Dhe nuk ka fuqi dhe pushtet përveç se nga Allahu.”

Shejkh Mukbili (Allahu e mëshiroftë) është pyetur ndërsa ai qëndronte i ulur në vendin e tij:

- Si u përhap Daueti Selefij në Jemen? Kush ishte shkaku?

Ai tha: Shkak është dallimi, veçimi (*et-temjiẓ*). Ne u dalluam, u veçuam nga Njerëzit e Bidatit (*ena temjiẓuna ‘an Ehlil-Bid’ah*) dhe kështu Allahu e përhapì Sunetin... **kur ndonjë njeri i bidatit vinte në Xhami për të mbajtur ndonjë fjalim, atëherë të gjithë ata që ishin në Xhami largoheshin – domethënë i bënë atij hexhër (e bojkotonin, e braktisnin) dhe e poshtëronin...** Pra, ata ishin të kënaqur me Sunetin, ata e njihnin pozitën e lartë që kishte ai (Suneti), e njihnin të keqen që ka bidati dhe të keqen që buron prej tij.

Ishte pra – o vëllezërit e mi – dallimi i Ehli-Sunetit nga hizbijunët dhe njerëzit e bidatit (*Ehlul-Bid’ah*) arsyeja më e madhe për përhapjen e Sunetit. Kurse po të përzihesh dhe bashkohesh me ata, kjo gjë do të sjellë rezultat të kundërt dhe kjo është shkak që njerëzit e bidatit (*Ehlul-Bid’ah*) ta mposhtin Sunetin dhe njerëzit e tij. Dhe kështu përhapen bidatet.

Unë i lutem Allahut që të na mbajë ne dhe ju të palëkundur në Sunet dhe të na bëjë që të punojmë sipas tij dhe të duam dhe të urrejmë për hir të tij. Po.¹⁴

¹⁴ Shkëputur nga Kaseta me titull: “Përgjigje vendimtare për pyetjet rreth metodologjive të reja”, ana e parë e kasetës.

Personaliteti dhe Karakteri i Shejkh Mukbilit:



Si familjar:

Ai ishte mjaft i sjellshëm me anëtarët e familjes së vet. Nuk tregohej arrogant dhe nuk i mundonte gratë e tij. Tregohej gjithmonë i sjellshëm dhe i duruar. U rrinte vazhdimisht afër fëmijëve të tij duke u interesuar për hapat që hidhnin në fenë e Allahut. Ai kujdesej që ata të mos josheshin nga mashtrimet e kësaj dynjaje dhe i nxiste që kur ishin të vegjël që të mësonin Kur'anin, gjuhën Arabe, Hadithin, Fik'hun etj.

E bija e tij, Umm 'Abdullah el-Uadi'ja rrëfen:

“Ai këshillonte që të ruheshim nga shoqëria sepse ajo është e devijuar dhe e lajthitur. Ajo është një shoqëri që garon drejt asaj që është e gabuar dhe e padobishme, me përjashtim të atyre që i ka mëshiruar Allahu.

- Ai na paralajmëronte kundër kryeneçësisë dhe mendjemadhësisë karshi bashkëshortit. Ai thoshte: “Nuk ka asnjë mirësi tek ajo femër (që është kryeneçe dhe mendjemadhe me burrin e saj).”
- Ai na inkurajonte për zuhd në jetën e kësaj dynjaje që do të shkatërrohet.
- Ai na mësonte që të kishin si qëllim me atë çfarë hanim e pinim fuqizimin e veteve tona për t'iu bindur Allahut, në mënyrë që të marrim shpërblim nga Allahu për këtë. Ai thoshte: “Mos u mundoni shumë me përgatitjen e ushqimit, do të hamë ç'të jetë e mundur.”
- Ai na jepte kurajo vazhdimisht. Ai nuk ishte nga ata baballarë që i shkurojnë vajzat dhe familjet e tyre. Ai na e lehtësoi punën duke e thjeshtuar atë me qëllim që ne të vazhdonim të përparonim dhe të përgatiteshim për të mësuar dhe për të fituar dije të dobishme.”

Madje, ai i këshillonte të tjerët duke u thënë: “Kini kujdes, kini kujdes se mos da'ueti dhe mësimdhënia ju mbajnë larg nga familjet tuaja, sepse vërtet, çdonjëri nga ju është bari dhe ai do të pyetet për kopenë e tij.”

Si Zahid...

Shtëpia e tij ishte prej balte kurse dysHEMEJA prej dërrase. Zakonisht flinte tre deri në katër orë gjumë në ditë, kurse orët e tjera i shpenzonte mbi libra ose duke dhënë mësim ose duke bërë ibadet.

Shejkh Mukbili thoshte për veten e tij: “Unë kam mangësitë e mia.” Pastaj thoshte: “Unë s’jam i kënaqur nga vetja ime.”

Kur filluan t’i dilnin thinjat në mjekër, u mërzit shumë dhe tha me veten e tij: “Çfarë ke bërë për Islamin dhe Muslimanët?”

Dhe kur Daueti Selefij u bë më i fuqishëm dhe u përhap gjithandej, ai tha: “Kjo është diçka që ka dashur Allahu dhe nuk ka ardhur si rezultat i fuqisë, oratorisë, diturisë apo pasurisë sonë.”

Ai ishte shumë i përlur dhe modest me të tjerët dhe përpiquej t’i ndihmonte nevojtarët. Njëherë, disa nga studentët e tij nuk kishin asgjë për të ngrënë. Shejkh Mukbili kishte një dele të cilën e milte për të ushqyer me qumësht vajzën e tij. Kur mori vesh për gjendjen e studentëve, ai e theri dhe ua ndau nxënësve.

Edhe pronën që kishte trashëguar, ai e dhuroi falas për studentët e dijes që ata të ndërtonin shtëpi dhe të vendoseshin aty me familjet e tyre.

Pra, në njëfarë mënyre jeta e tij nuk ndryshon shumë nga jeta që kanë kaluar Selefët.¹⁵

Megjithë sprovat, mundimet, kërcënimet, varfërinë e tejskajshme që i mbajti mbi shpinë gjatë tërë jetës së tij, Shejkh Mukbili nuk u hoqi dorë nga thirrja për

¹⁵ Imam Bukhari ka ngrënë bar për tri ditë rresht për shkak se nuk kishte asnjëfarë pasurie me vete. Disa herë hoqi dorë nga kërkimi i dijes për shkak të varfërisë ekstreme, por njerëz të ndryshëm e kanë inkurajuar që ta vazhdonte rrugën e dijes duke e ndihmuar me të holla. Shu’be ka thënë: “Kushdo që e kërkon këtë hadith ka për të falimentuar. Unë kam falimentuar aq rëndë sa kam shitur edhe një tas të nënës sime të cilin e shita për shtatë dinarë.”

Sufjan Ibn ‘Ujejne ka thënë: “Nëse këto shishe boje hyjnë në shtëpinë e dikujt, ato sjellin veç mjerim për gruan dhe fëmijët e tij.” Njëherë Sufjani pyeti dikë: “Me çfarë merresh?” Ai iu përgjigj: “Me kërkimin e Hadithit.” Kurse ai i tha: “Atëherë përgëzoje familjen tënde me varfëri.”

I thanë Sufjan eth-Theurit: “Çfarë të pengoi që të shkoje tek Zuhriu?” Ai u përgjigj: “Nuk kisha as edhe një dirhem.”

Ebu Hatim dhe Ebu Zur’ah gjatë rrugës në kërkimin e hadithit u binte të fikët nga uria.

tek Allahu dhe Suneti i Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*). Madje as pasuritë dhe ofertat e hizbive nuk e njollosën nderin e tij. Ai nuk e shiti da'uetin e tij për një çmim të turpshëm në këtë dynja dhe nuk ia shtriu dorën shijave, sufive, ikhuanëve, tekfirsave, hizbijes së Turathit etj. Për të ishte e mjaftueshme mbështetja e palëkundur në Allahun *Subhanehu ue Te'ala*.¹⁶

Si Dijetar...

Të bën përshtypje fuqia e tij për të mësuar përmendësh hadithin, defektet e fshehta (të hadithit), transmetuesit, gjendja e tyre dhe gjithashtu rregullat e gramatikës Arabe, etj.

Si edukator...

Të bën përshtypje durimi i tij i madh e i stërgjatur në mësimdhënie dhe edukim (*terbije*) dhe sa i bindur e i sigurt ishte ai për ndihmën e Allahut '*Azxe ue Xhel* për këtë Dauet, në një kohë kur i shohim Pasuesit e Epsheve (*Ehlul-Ehua*) të angazhuar në një luftë të ashpër kundër këtij Daueti. Ai thoshte gjithmonë: "Ky Dauet o vëllezër ka për t'u përhapur në një mënyrë të pashembullt", pavarisht kurtheve të kurthngritësve dhe ndikimeve që patën ato mbi vëllezërit dhe Dauetin në çdo vend. Por që atëherë çështjet ndryshuan ngase Shejkhu ishte i bindur për këtë dhe të gjitha falenderimet i takojnë vetëm Allahut.

¹⁶ Ka ardhur në Sahihun e Muslimit: "*Vërtet sadakaja nuk është gjë tjetër vetëm se ndyrësira e njerëzve.*" Gjithashtu tek dy Sahihët ka ardhur: "*Kush nuk u kërkon njerëzve, Allahu do ta bëjë atë të kënaqur. Dhe kush përpiqet që të jetë i pavarur, Allahu ka për ta bërë atë të pavarur. Dhe kush bën durim, Allahu do ta bëjë atë të durnar. Askujt nuk i është dhënë begati më e mirë dhe më e madhe sesa durimi.*" 'Ali Ibn Ebi Talib (*radij-Allahu 'anhu*) ka thënë: "Ai që rron nga duart e njerëzve është si shembulli i atij që mbjell një pemë në tokën e dikujt tjetër." 'Umer Ibnul-Kattab (*radij-Allahu 'anhu*) ka thënë: "O ju këndues të Kur'anit mbajini lart kokat tuaja." [D.m.th. mos i mbani kokat ulur për t'u treguar modest sepse modestia është në zemër!] Sufjan eth-Theuri ka këshilluar 'Ali Ibn Hasenin duke i thënë: "O vëllai im! Ti duhet të fitosh atë që është e pastër dhe që e ke fituar me djersën tënde dhe ruhu se mos ha apo se mos vishesh nga ndyrësitat e njerëzve. [D.m.th. ki kujdes se mos rron me sadakanë që të japin njerëzit!] Vërtet, ai që ha nga ndyrësitat e njerëzve është si shembulli i një burri që ka në pronësi katin e dytë të një ndërtese por jo katin e parë, kështu që ai jeton gjithmonë me frikën se mos rrënohet kati i parë duke bërë që të bjerë edhe kati i dytë. Dhe ai që ushqehet me ndyrësitat e njerëzve flet me teka dhe epshe duke rënë në një mendje me njerëzit nga frika se mos ata e braktisin. O vëllai im! Nëse merr ndonjë gjë nga njerëzit t'i do ta mbash gjuhën tënde (që të mos ua thuash atyre të vërtetën) dhe do t'i nderosh disa njerëz kurse disa të tjerë do t'i përbuzësh..."

Dhe nuk ka dyshim se ky është një tipar madhështor sepse bindja (*jekin*) është furnizim për t'u vendosur fuqimisht (*temkin*) mbi tokë, sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar:

وَجَعَلْنَا مِنْهُمْ أُمَمَةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا لَمَّا صَبَرُوا وَكَانُوا بِعَايَتِنَا يُوقِنُونَ ﴿٢٤﴾

“Dhe Ne i bëmë ata prijësa duke udhëhequr me Urdhërin Tonë kur ata u treguan të duruar dhe ishin të bindur në Shenjat (Ajetet) Tona.”¹⁷

Dhe sa të shumtë janë ata njerëz që janë kthyer nga gjysma e rrugës që kanë bërë për shkak të humbjes së *jekinit* (bindjes). Ndoshta ka nga ata që mund të jenë kthyer nga vendi ku kanë qenë ndërkohë që mes tyre dhe triumfit, krenarisë dhe vendosjes së tyre mbi tokë kishte mbetur një distancë fare e vogël!!! Allahu na ruajt e na ndihmoftë!

Si njeri që urdhëronte të mirën dhe ndalonte të keqen...

Ai u përball i vetëm me një popull injorant që ndiqte epshet dhe traditat e kota. Ai i urdhëroi ata për punë të mira dhe i ndaloi nga punët e këqia. Në fillim të Dautit të tij ai shkonte te ata dhe u thërriste me sa kishte fuqi: “Përzierja e burrave me gratë është një gjë e keqe.”

Dihet mjaft mirë se Shejkhu nuk i frikësohej akuzave dhe fyerjeve të askujt në Rrugën e Allahut. Nëse ai besonte tek një çështje e deklaronte atë dhe nëse i hapej zemra për disa çështje do të vazhdonte me to pavarësisht nëse kishte ndonjë që nuk pajtohej me të. Ai nuk ia vinte veshin asnjë polemizuesi edhe përkundër numrit të madh të tyre. Dhe kjo padyshim është një cilësi e lavdërueshme dhe është një degë e *jekinit* (bindjes, sigurisë) dhe një vizion i pastër e i qartë për të vërtetën pa e marrë parasysh numri i pasuesve.

Si hatib (ligjërues)...

Ai kishte fjalë dhe thirrje të fuqishme të cilat i trondisnin zemrat e paturpësisë dhe u jepnin forcë shpirtave të dobët. Thirrja e tij bazohej mbi Sunet dhe ai nuk u kthehej historive dhe rrëfimeve të kota që njerëzve të pandërgjegjshëm u interesojnë kaq shumë. Drita e Haditheve Profetike vezullonte gjithmonë në fjalët e tij.

¹⁷ Sexhde, 24.

Si mësues...

Do të gjeje në mexhlistet që mbante me nxënësit e tij shumë ëmbëlsi dhe nur. Ai u drejtonte atyre pyetje të shumta në lidhje me hadithin, transmetuesit e tij, gramatikën e gjuhës Arabe, thëniet e poetëve dhe kuptimet e tyre. Ai i kontrollonte studentët e tij më inteligjentë duke u bërë pyetje të cilat nuk kuptoheshin përveç se nga ata që ishin të pajisur me inteligjencë dhe aftësinë e të kuptuarit. Interes të veçantë tregonte për studentët jo-Arabë të cilët kishin shtegëtuar nga të katër cepat e globit për të kërkuar dije në Institut. Edhe pse mexhlistet e tij mund të ishin të stërgjatura ato nuk ishin të mërzitshme apo të lodhshme. Mësimet e tij ishin të shumta e të mjaftueshme dhe perlat e dijes së tij u përhapën gjithandej.

Disa herë u është drejtuar studentëve të tij duke u thënë: “Tani ju konsideroj si shokët e mi.”

Ai e pranonte të vërtetën nga çdo person edhe nëse ishte mashkull apo femër, i ri apo i vjetër. I bëhej shumë qejfi kur dikush ia bënte të qartë gabimin dhe pastaj bënte dua për të. Pastaj e bënte të qartë gabimin e tij para njerëzve.

Humori ishte një pjesë e pandarë e karakterit të tij. Ai bënte shaka shpesh me shtudentët e tij. Një herë ai i pyeti ata: “Përse Shejkh Muhamed bin ‘Abdul-Uehab përmend në Kitabut-Teuhid ndalimin e pikturave (të njerëzve) dhe ç’lidhje ka kjo me Teuhidin? Një nga fëmijët iu përgjigj kësaj pyetjeje dhe tha: “Sepse ndoshta ato adhuroheshin në vend të Allahut.” Kurse ai, Allahu e mëshiroftë, tha: “Ti je një Shejkh.”

Një herë tjetër ai tha: “Ai që nuk e njeh Ahmed bin Muhamed esh-Shejbanin të çohet në këmbë.” Kështu, shumë nga vëllezërit u çuan në këmbë. Pastaj ai tha: “Ai është Ahmed bin Hanbel.”

Në një rast tjetër ai tha: “Çfarë dini për Ebu Murrah?” Studentët u zunë ngushtë duke vrarë mendjen për transmetuesit e hadithit dhe asnjëri prej tyre nuk u përgjigj. Pastaj ai tha: “Ai është Shejtani.”¹⁸

Në çështjet e ikhtilafit (mospajtimit në mendime)...

¹⁸ Ebu Murrah është nofka e Iblisit.

Do të dëshmonim zemërgjerësinë tij ndaj kundërshtarit, pra ai ishte i hapur me kundërshtarët e tij në ato çështje ku mospajtimi (*ikhtilaf*) është i lejuar. Kishte raste kur Shejkh Mukbili jepte ndonjë fetva dhe pastaj një nga studentët e tij sillte një tjetër fetva për ta kundërshtuar. Ka ndodhur që edhe studentet nga mesi i grave e kanë kundërshtuar atë në lidhje me saktësimin apo dobësimin e ndonjë hadithi ose për ndonjë çështje të fik'hut dhe Shejkhu shpesh herë thoshte: “Unë nuk ia imponoj mendimin tim askujt dhe nuk dua që dikush të më imponojë mendimin e tij, përveç se me argument.” Dhe e gjithë kjo vinte nga dija që kishte ai dhe aftësia e mprehtë për t'i kuptuar çështjet.

Studentët e Shejkh Mukbilit:



Muslimanë nga të katër cepat e globit kanë shkuar për të marrë dije në institutin e Shejkh Mukbilit në Demmaxh. Ata ndërtonin shtëpi prej balte e jo fort të rehatshme për të qëndruar pranë tij. Falë përkushtimit dhe përkujdesjes që ai tregonte, studentët e dijes shtoheshin për çdo vit dhe dija e tij u përhap në mënyrë masive. Thuhet se ai ka qenë një nga dijetarët më të vizituar nga njerëzit gjatë këtyre viteve. Nga ata që studjuan në Institut pati të atillë që spikatën në fusha të ndryshme të dijes dhe u bënë trashëgimtarë të denjë të Shejkh Mukbilit. Nga studentët e tij Vlen të përmendim më të dalluarit:



Muhamed bin 'Abdul-Uehab el-Uasabi:

Ai është dijetari i nderuar, fekihi, zahidi, thikati (i besueshmi) Ebu Ibrahim Muhamed bin 'Abdul-Uehab el-Uasabi el-'Abdeli, Allahu e ruajt, një nga studentët më të vjetër të Shejkh Mukbilit, aq sa ai e quante atë "Khalifi im". Ai është një nga mbrojtësit e palodhur të Sunetit dhe pasuesve të tij. Ai ka ngritur një qendër studimore në Hudejde ku jep mësim në fusha të ndryshme të dijes. Gjithashtu ka shkruajtur një sërë librash me tematika të ndryshme, prej të cilëve përmendim: *el-Kaulul-Mufjjd fji Edileti-Teuhijd* (Fjala e dobishme rreth Argumenteve të Teuhidit), *et-Terdu uel-Tbad 'an Haudi Jeumil-Mi'ad* (Përfashtimi dhe Distancimi nga Haudi i Pejgamberit në Ditën e Takimit), *Hukum Rida'il-Kebir*, *el-Kaulus-Sauab fji Hukmil-Mibrab* (Fjala Korrekte mbi Gjykimin e Mihrabit), *el-Xheuberu fji 'Adedi Deraxbatil-Minber* (Thelbi i Numrit të Shkallëve që duhet të ketë Minberi) dhe broshura *Tuhfetul-Arijb fji Ittikhadil-'Asa lil-Khatib* (Vepër Mjeshtërore rreth Mbajtjes së Shkopit nga Hatibi kur ai mban Hytbe).



Jahja bin 'Ali el-Haxhuri:

Ai është Dijetari i nderuar, Ebu 'Abdu-Rrahman Jahja bin 'Ali el-Haxhuri, Allahu e ruajt, përfaqësuesi i Shejkh Mukbilit gjatë jetës së tij dhe zëvendësuesi i tij në Institutin *Darul-Hadijth* në Demaxh. Ai i ka mësuar përmendësh të gjashta përmbledhjet më të sakta me hadithe: dy Sahihët (Bukhari dhe Muslimi) dhe katër Sunenet (Nesai, Ibn Maxheh, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu). Ai është autor i mjaft librave, si: *Sherhul-Erbe'in en-Neueni*, *Abkamul-Xhumu'a*, *Islah el-Muxhtema'*, *Subhush-Sharik*, *el-Erbe'unel-Hisan*, *Dija'us-Salikin fji Abkami ue Edebi Musafirin*, *et-Tahdhijr min Ehami Seuari fil-Khajr*, *Keshful-Uu'atha*, *Nasihati lit-Tuxhar*, *Tahdhirun-*

Nubela 'ani et-Teshebbub bin-Nisa, el-'Adhbul-Me'in, Hashedul-Edile, el-Hath net-Tabrijd 'ala Te'alum Abkamil-Merijd, Abkam et-Tejmum, Edrarul-Hizbijje 'alel-Ummetil-Islamije (Rreziku i Hizbijes mbi Ummetin Musliman), et-Texhlijetu li-Abkamil-Hedije uel-Ud'hije, Sherh Mendhumatil-Ahsa'i, el-Erbe'unel-Hisan li-Tenbihil-Enam 'ala Fadlil-IXhtima' 'ala et-Ta'am, dhe mjaft libra të tjerë. Në parathënien që i ka bërë librit të Shejkh Jahjas "Subhu-Sharik", Dijetari i madh Ahmed en-Nexhmi (rahimehullah) ka thënë: "Shejkh Jahja (Allahu e shpërbleftë me një shpërblim të mirë) e ka refuzuar atë (Zindanin) në këto fragmente të shkurtra apo edhe në vende të tjera me një refuzim që ia mbyll gojën kundërshtarit duke përdorur argumente të qarta e të prera nga Kur'ani dhe Suneti i vërtetë, kështu që Allahu e shpërbleftë atë me një shpërblim të mirë dhe e bagatoftë - dhe Allahu i shtoftë ata si puna e tij, ata që e mbrojnë të vërtetën, e ndihmojnë Teuhidin dhe i ruajnë kufijtë e tij." Shejkh Rabi' Ibn Hadi el-Medkhalij ka thënë: "Shejkh Jahja është nga njerëzit më të virtytshëm." Gjithashtu, Shejkh Rabi', Allahu e ruajt, ka thënë: "Vëllai juaj, Shejkh Jahja, është nga Ulematë më të mirë!" Shejkh Mukbili ka thënë për të: "Shejkhu i shquar, Muhadithi, Fekihu, Jahja Ibn 'Ali el-Haxhuri..." Kur është pyetur Shejkh Mukbili në Xhidde (kur ka qenë i shtruar në spital në Saudi pak kohë para se të vdiste) se kush është njeriu më i ditur në Jemen, ai heshti për një çast dhe pastaj tha: "Shejkh Jahja!"

✿ 'Abdu-Rrahman el-Adeni:

Ai është Dijetari i nderuar, Ebu 'Abdil-lah 'Abdu-Rrahman bin 'Umer bin Mur'ij bin Burajk el-Adeni, Allahu e ruajt, një nga studentët e afërt të Shejkh Mukbilit, Allahu e mëshiroftë. Ai jep mësim në qytetin Shihr (Harah el-Khur). Shejkh Mukbili (rahimehullah) ka thënë për të: "Ai është bërë një burim për vëllezërit e tij, të cilët mund t'i drejtohen për fushat e ndryshme të dijes." Shejkh Rabi' Ibn Hadi el-Medkhalij ka thënë për të: "Shejkh 'Abdu-Rrahman është nga njerëzit më të virtytshëm."

✿ Muhamed el-Imam:

Ai është Dijetari i nderuar, Ebu Nasr Muhamed bin 'Abdil-lah bin Husejn er-Rajmi, i njohur me nofkën el-Imam, një nga pionerët e Dauetit Selefij, një shkrimtar i zellshëm, një thirrës entuziast i Sunetit. Zëri i tij është vërtet i mahnitshëm kur ai fillon të këndojë Kur'anin. Pasi u pajis me dijen e dobishme nga mësuesi i tij, Shejkh Mukbil bin Hadi, Allahu e mëshiroftë, ai shkoi në Ma'bar dhe ngriti aty një qendër studimore ku filloi të jepte mësim në fusha të ndryshme të Islamit. Numri i të rinjve që kanë studiuar aty shkon në disa mijë. Ai ka shkruajtur poashtu disa libra, prej tyre: *Tenuirudh-Dhulumati fij Mefasidil-*

Intikhabat (Lëshimi i dritës mbi errësirën e Sthurjes së Votimeve), *el-Muameratul-Kubra 'alel-Meratil-Muslimetu* (Komplotet më të Mëdha Kundër Gruas Muslimane), *el-Bejan lima 'alejbi Xhami'atul-Iman* (Sqarim për gjendjen në të cilën ndodhet Universiteti *el-Iman* – Universiteti i 'Abdul-Mexhid ez-Zindanit), *Ikebarul-Wufud fij Hukmi Zijareti Kabri en-Nebij Hud* (Njoftimi i masave lidhur me rregullat e vizitës në varrin e Pejgamberit Nuh), *el-Akhta'ul-Mute'adide fij Haxhil-Mer'atil-Muteberrixhe* (Gabimet e shumta që bëhen gjatë Haxhit nga Gruaja që nuk mbulohet ashtu siç duhet), *Irshadun-Nadhir ila Ma'rifeti 'Alamati es-Sahijr* (Udhëzimi i atij që shikon për mësimin e shenjave të magjistarit), *et-Tenbihul-Hasen fij Meukifil-Muslim minel-Fiten* (Qëndrimi që duhet të mbajë Muslimani ndaj Fitneve) dhe libra të tjerë.



'Abdul-'Azizj el-Bura'i:

Ai është Dijetari i nderuar, Ebu Dherr 'Abdul-'Azizj bin Jahja el-Bura'i, Allahu e ruajt, një thirrës guximtar për tek Allahu, një mësues i përgatitur dhe elokuent, një shkrimtar i begatshëm dhe një nga Poetët e Dautit Selefij. Shejkh Mukbili, Allahu e mëshiroftë, e ka lavdëruar atë kur ka thënë: “Vëllai, 'Abdul-'Azizj el-Bura'i, i cili është shumë i mprehtë në kritikizmin e tij (ndaj kundërshtarëve të Sunetit).” Ai ka ngritur një qendër studimore në Mefrak Xhejsh (Ibb) ku jep mësim dhe gjithashtu ka shkruajtur disa libra, si *Bidajetul-Inbiraf* (Fillimi i Devijimit), *Tekatuf el-Mutesakittijn* (të Rrëzuarit që përpiqen të ngrejne njëri-tjetrin, që është një refuzim i shkëlqyer kundër bidatçiut Ebul-Hasen el-Ma'ribi... etj.



Muhamed es-Sumali:

Ai është Dijetari i nderuar, Ebu 'Abdul-Hamid Muhamed bin Salih es-Sumali, Allahu e ruajt, një nga Thirrësit për tek Allahu, një mësues i begatshëm dhe Imam e Hatib. Ai ka ngritur një qendër studimore për shkencat e Islamit në Bir 'Abid (San'a) e cila sot konsiderohet si një nga fortesat e Ehli-Sunetit në atë vend. Allahu ka zbritur bereqet të madh duke bërë që të përhapet daue dhe dije e begatshme nga kjo qendër.



'Abdullah bin 'Uthman edh-Dhimari:

Ai është Dijetari i nderuar, Ebu Munir 'Abdil-lah bin 'Uthman el-Kissi edh-Dhimari, një prej Thirrësve frymëzues i cili duket sikur e ka krijuar Allahu vetëm për këtë punë, saqë shumë prej Muslimanëve kanë përfutuar prej tij. Ai është Hatib dhe mësues në vendin e tij.



Umm 'Abdullah el-Uadij'a:

Ajo është Umm 'Abdullah A'ishah bintu Mukbil bin Hadij, e bija e Shejkh Mukbilit, një nga Dijetaret e botës Islame sot. Shejkh Mukbili ka thënë për të: "Ajo ka dije të thellë në shumë fusha të Fesë dhe ka edukatën e të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*). Ajo është e dalluar dhe mjaft e kujdesshme në ruajtjen e kohës së saj. Prandaj Allahu e ka bërë të begatshme veprimtarinë e saj. Ajo është përherë e gatshme që t'u bëjë dobi motrave të saj dhe u mëson atyre një libër deri në fund dhe pastaj kalon në një libër tjetër." Gjithashtu, ai i ka thënë asaj kur ajo ishte ende e re: "Shpresoj se ti do të bëhesh një Fekihe." Ajo vazhdon të japë mësim për gratë në Institutin *Darul-Hadijth* në Demaxh dhe ka shkruajtur gjithashtu disa libra, prej tyre: *Nasihati li-Nisai Kadaja Tehummul-Mera Fetaua li-Nisa, es-Sahijbul-Musned minesh-Shema'il el-Muhamedije, el-Xhami'us-Sahijh fil-Ilm ue Fadlihi, Nubdhetun-Mukhtesera min Rida' Ualidi el-'Alame Mukbil bin Hadi*.

Edhe pse nuk po përmenden të gjithë trashëgimtarët e Shejkh Mukbilit,¹⁹ mjafton të themi se këta janë ata të cilët po e çojnë përpara Da'uetin Selefij në Jemen e më gjerë dhe janë njëkohësisht Dijetarët e Sunetit tek të cilët Muslimanë nga Lindja dhe Perëndimi shtegëtojnë për të kërkuar dijen Islame.²⁰ Por fatkeqësisht, armiqtë e Menhexhit Selefij nuk i kanë kursyer as këta dijetarë, sikurse nuk e kursyen as mësuesin e tyre dhe as dijetarët e tjerë, qofshin ata që janë ende gjallë apo edhe ata që kanë vdekur. Janë përhapur mjaft zëra dhe thashetheme nga njerëz të cilët kërkojnë me çdo mënyrë që të hedhin baltë mbi studentët e Shejkh Mukbilit. Për këtë arsye, dijetari i madh, el-Alame Rabi' Ibn Hadi el-Medkhalij, Allahu e ruajt, është pyetur:

"Si është gjendja e shkollës që është themeluar nga Shejkhu, el-Alame Mukbil Ibnu Hadi el-Uadi'i, Allahu i Lartësuar pastë mëshirë për të, sepse disa njerëz kanë filluar të flasin rreth tyre dhe i shajnë ata; çfarë këshille do t'u jepnit njerëzve të Jemenit që janë në këto shkolla?"

Shejkhu u përgjigj:

¹⁹ Gjithashtu në Demmaxh është Shejkh Jahja es-Selwi, origjina e të cilit është nga Etiopia. Ai ka qëndruar në Demmaxh për 18 vjet dhe mbahet si një nga dijetarët më të mëdhenj në atë vend. Poashtu, aty është edhe Shejkh Zejd el-Uasabi dhe Shejkh 'Abdul-Kerijm el-Haxhuri.

²⁰ Kur është pyetur për ata që përhapin zëra se gjoja pas vdekjes së Shejkh Mukbilit, Allahu e mëshiroftë, në Jemen nuk ka më dijetarë, Shejkh Rabi' el-Medkhalij e ka hedhur poshtë këtë pretendim të rremë duke thënë: "Po Shejkh Muhamedi (el-Uasabi) çfarë është? Po Shejkh Jahja (el-Haxhuri) çfarë është? Po vëllezërit e tjerë që janë shokët e tyre?"

“Uallahi ajo që besojmë është se ata janë në gjendjen më të mirë – dhe lavdërimi i takon Allahut – dhe ata e kanë ngritur lart dauen për tek Allahu dhe Teuhidi i Tij dhe përkushtimin e Fesë me singeritet vetëm për Të dhe ndjekjen e Pejgamberit (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*). Ata janë mjaft të zotë në marrjen e dijes dhe përhapjen e saj. Në dauen për tek Allahu *Tebarake ue Te’ala* puna e tyre i kënaq dhe i gëzon gjokset (zemrat) e besimtarëve – dhe çdo besimtar i vërtetë është i gëzuar me ta, kurse çdo gënjeshtar dhe epsharak është i zemëruar me ata – dhe Allahu na ruajt.”



[Darul-Hadijth, shkolla e themeluar nga Shejkh Mukbil bin Hadi rahimehullah](#)

Ai vazhdoi më tej:

“...na kanë njoftuar se vetëm në Demaxh ata kanë arritur në pesë deri në shtatë mijë (vetë) që janë të preokupuar me dije ditë e natë. Ata nuk kanë as pushime, as festa dhe as gjëra të tjera. Dituri ditën dhe natën dhe studim në shkenca të ndryshme, Hadith, Tefsir, Fik’h, Gramatikë dhe shkenca të tjera Islame, Allahu ju bekoftë. Allahu u dhëntë sukses atyre. Gjithashtu, shkollat e tjera si ajo janë plot zell dhe energji në përhapjen e daudetit. E gjithë kjo është sipas rrugës së Selefëve: zuhd, devotshmëri, drejtësi sipas rrugës së Selefus-Salih. Shejkh Mukbili ua ka dhënë këtë edukatë, prandaj ata nuk e kanë ulur kokën dhe nuk ua kanë shtrirë dorën xhemateve të hizbijeve që vetëquhen (shoqata) bamirëse.

Bamirësi... ata (hizbijet) ua japin dorën atyre që u nënshtrohen, atyre që ecin në shtigjet e hizbijes dhe atyre që e kundërshtojnë menhexhin Selefij.²¹

Ata (studentët e Shejkh Mukbilit në Jemen) e kanë ngritur kokën lart dhe nuk u janë dorëzuar atyre, nuk janë joshur nga pasuria e tyre dhe kanë qëndruar të duruar si në kohë të mira ashtu edhe në kohë të këqija. Ata janë treguar të duruar dhe falenderues. Ata na kujtojnë kohën e të Parëve tanë të Mirë (*es-Selefus-Salih*) për teuekulin, mbështetjen tek Allahu, dinjitetin, nderin dhe përhapjen e këtij Menhexhi vetëm për Fytyrën e Allahut *Tebarake ue Te'ala*. Dhe ne i lutemi Allahut që t'u japë atyre singëritet."

Ai thotë më tej:

"Dhe këshilla ime për ta është që të kenë dashuri ndërmjet veti, të jenë të gjithë të bashkuar, të lidhen fort me njëri-tjetrin, ta forcojnë vëllazërinë dhe të mos ua vënë veshin thashethemeve ngase armiq të Sunetit po bëjnë ç'është e mundur, ata nuk lodhen dhe nuk mërzhiten nga përpjekjet për t'i përçarë ata dhe për t'i ndarë nga njëri-tjetri. Prandaj ata fshihen andej-këndej për të shkaktuar përçarje, përplasje dhe mosmarrëveshje."

Në fund ai thotë:

"Dhe këshilla që i jap vetes sime dhe atyre është që ata të mos ua vënë veshin këtyre keqbërësve, atyre që bëjnë ç'rregullime në tokë dhe nuk sjellin dobi, por janë tërbuar për shkak se Suneti i të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sellem*) po përhapet dhe menhexhi Selefij po përhapet, prandaj ata po mundohen në shumë mënyra që t'i mposhtin Selefijinët dhe t'i ndajnë ata nga njëri-tjetri. Kështu që, ata (studentët e Shejkh Mukbilit) duhet të ruhen nga kurthet e njerëzve të tillë. Ne i lutemi Allahut që të na bëjë ne dhe ata të palëkundur në Sunet. Vërtet, Zoti ynë e dëgjon duanë."²²

²¹ Domethënë Hizbitë ndihmojnë nga ana financiare dhe ofrojnë mbështetje vetëm për ata që u nënshtrohen urdhërave të tyre, ata që punojnë për hesapin e tyre dhe mbi të gjitha luftojnë kundër Selefive dhe menhexhit Selefij.

²² Në dhjetë ditët e fundit të Ramadanit (1429 Hixhrij), një vëlla selefij me emrin Ajmen el-Adeni e pyeti Shejkhun, Muxhahidin Rabi' Ibn Hadi el-Medkhalij, Allahu e ruajt, për atë paralajmëron kundër studimit në Demaxh: "O shejkh, a na këshillon që të udhëtojmë në Demaxh për të kërkuar dije në këtë kohë?" Shejkh u përgjigj duke thënë: "A nuk të vjen turp që bën një pyetje të tillë! Nuk ke ndonjë pyetje tjetër? Si mos të këshilloj unë që të merret dija në Demaxh?" Shejkhu përmendi gjithashtu ata që i ndalojnë të tjerët për të mos shkuar në Demaxh, duke thënë: "Ata janë njerëz që të largojnë nga rruga e drejtë. Ai (Demaxhi) është një qendër ku mësohen dhe studjohen të gjitha shkencat e Fesë. Dhe pasha

Ai ka thënë gjithashtu në këshillën e tij drejtuar nxënësve të Shejkh Mukbilit (*rahimehullah*):

“Të gjithë ju mësoni jo për hir të diplomave dhe ju nuk jepni mësim me qëllim që të fitoni para. Sot në Emirate dhe në Arabinë Saudite një mësues i paaftë mund të marrë një rrogë prej 20.000 - 30.000, kurse këta njerëz (nxënës të Shejkh Mukbilit) nuk marrin asgjë, as nga pushtetarët dhe as nga ndonjë tjetër. Ata mësojnë për hir të Allahut dhe japin mësim për Fytyrën e Allahut *Subhanehu ue Te'ala*. Dhe kjo pasha Allahun është diçka e veçantë që e keni ju, është diçka e veçantë në *da'uetin* tuaj. Respektojeni këtë begati dhe punoni sa të keni mundësi që ta mbani fuqinë e saj, Allahu ju bekoftë të gjithëve.”

Shejkh Felah bin Isma'il el-Mindikar, Allahu e ruajt, ka thënë: “Shejkh Salim et-Tauil shkoi në Jemen për t'u bërë vizitë vëllezërve Selefijinë e kur u kthye tha se ata (studentët e Shejkh Mukbilit) jetonin si në kohën e Sahabëve!!”

Vetë Shejkh Salim et-Tauil ka thënë: “Ajo që ma shtoi dëshirën për të takuar vëllezërit e mi Selefij në Jemen ishte mënyra se si Shejkh Rabij' i përshkroi ata me fjalët: **“Selefizmi në Jemen është Selefizmi më i fuqishëm në botë dhe ata kanë diçka që i dallon (nga Selefitet e tjerë) dhe ata nuk futen në zgjedhje apo në politikë.”**

Shejkh Muhamed Ibn 'Abdul-Uehab Merzuk el-Bena, një nga dijetarët më të vjetër në Arabinë Saudite (Allahu e ruajt) ka thënë: “Pasha Allahun, studentët e tij tani janë nga më të mirët që mund të gjenden.” I thanë: “Domethënë nuk është ashtu siç pretendojnë disa njerëz se ata kanë ndryshuar pas (vdekjes së) Shejkh Mukbilit?”

Shejkhun tha: “Pasha Allahun, nuk di ç'të them. **Pasha Allahun, tani vendi më i mirë për të mësuar Selefizmin me dije dhe vepra - tamam ashtu siç është ai - është Demaxhi, pasha Allahun.** Tashmë *Ikbuanul-Muflisin* (Vëllezërit e Falimentuar) kanë hyrë në Mekke dhe e kanë shthurur atë. Pasha Allahun, ai që është i varfër mund ta mësojë Selefizmin dhe të veprojë sipas tij në Demaxh. Ky el-Marabi²³ ka dalë për t'i përçarë ata, Allahu e udhëzoftë ose përndryshe ia theftë shpinën.”

Allahun, askush nuk paralajmëron kundër kësaj qendre përveç atij që kërkon t'i largojë njerëzit nga rruga e Allahut.”

²³ Ai është Mustafa Sulejmani el-Misri, i njohur ndryshe si Ebul-Hasen el-Maribi el-Misri. Regjisori i fitnes që plasi në Jemen, e cila u përhap shumë shpejt në të gjithë botën duke shkaktuar një çoroditje të jashtëzakonshme mes Selefive.

Më parë ai ka qenë një tekfirs, anëtar i xhematit famëkeq *Tenekuf uet-Tebejjun* në Egjipt. Ai u martua me vajzën e njërit prej liderëve të Ikhuaneve në atë kohë, 'Abdul-Fettah Isma'il, i cili u ekzekutua bashkë me Sejjid Kutbin në vitin 1966. Pas persekutimeve që ndërmori qeveria Egjiptiane kundër ikhuanëve, Ebul-Haseni u shpërngul për në Jemen në fillim të viteve '80 dhe u vendos aty, ku u njoh edhe me Shejkh Mukbilin. Për një kohë shumë të shkurtër (thuhet 8 javë) studioi me Shejkh Mukbilin dhe më pas u vendos në qytetin Ma'rib. Por, sikurse ka thënë Imam Ahmed, "i riu është në edukimin e tij të parë", fill pas vdekjes së Shejkh Mukbilit, Ebul-Haseni nisi një luftë të egër kundër Selefite, fillimisht duke goditur Selefite të Jemenit dhe pastaj e zgjeroi frontin e luftës duke goditur edhe dijetarët e Saudisë dhe në mënyrë të veçantë Shejkh Rabij' bin Hadin, i cili e kishte këshilluar atë për më shumë se shtatë vjet me rradhë për gabimet e tij.

Pasi kishte qëndruar i fshehur për vite të tëra mes rradhëve të Selefijve, me vdekjen e Ulemave të mëdhenj (Shejkh Ibni Baz, Shejkhul-Albani, Shejkh Ibn 'Uthejmin dhe Shejkh Mukbili, Allahu pastë mëshirë për ta), ai doli hapur kundër Shejkh Rabisë dhe dijetarëve të tjerë Selefijë që e kishin këshilluar atë. Ebul-Haseni nxitoi që të përfshinte në këtë fitne dijetarë të ndryshëm që t'i përplaste ata me njëri-tjetrin, mes të cilëve edhe Shejkhun e nderuar 'Abdul-Muhsin el-'Abbad, duke e keqinformuar atë për realitetin e fitnes dhe duke e gënjyer për atë shumë çështje që kishin të bënin me të. Në këtë mënyrë ai ndoqi të njëjtën rrugë që ndoqën edhe 'Abdur-Rahman 'Abdul-Khalik, Selman el-Aude, Muhamed Se'id el-Kahtani, Adnan 'Ar'uri dhe Muhamed Magraui, të cilët përhapën çoroditje, rrëmuje, thashetheme e shpifje nga më të ndryshmet kundër atyre dijetarëve që ishin në dijeni për gabimet e tyre.

Ebul-Haseni goditi parimet dhe rregullat e Menhexhit Selefij, riorganizoi sulmin që ndërmori më herët shoku i tij, Adnan Ar'uri, duke rinovuar rregullat e tij, përfshi këtu rregullin e Muvazanatit, bashkëpunimin me partitë dhe organizatat e bidatçijve, lavdërimin dhe rekomandimin e bidatçijve dhe literaturën e tyre, sharjen e dijetarëve selefijë, akuzimin e tyre me terma si "hadadij", "të ashpër", "ekstremistë", "injorantë", "njerëz që ushtrojnë terror ideologjik", "njerëz të ndyrë e të poshtër" etj. Më shumë se tridhjetë dijetarë e kanë refuzuar atë dhe devijimet e tij, midis tyre Shejkh Ahmed bin Jahja en-Nexhmi (*rahimebullah*), Shejkh Salih el-Luhejdan, Shejkh 'Ali Nasir el-Fakijhi, Shejkh Salih es-Suhejmi, Shejkh Ubejd el-Xhabiri etj...

Shejkh Rabij' Ibn Hadi el-Medkhalij ka thënë për të: **"Ikhuanal-Muslimun, Xhemaati Tablig dhe grupet e partitë e Kutbijinëve nuk kanë mundur të bëjnë atë që ka bërë Ebul-Haseni në luftën e tij kundër Ehli-Sunetit."**

Me të vërtetë, çështja e tij nuk ndryshon aspak nga ajo që ka përshkruajtur Imam Berbahari: "Shembulli i bidatçiut është si shembulli i akrepit: ai futet nën rërë dhe nxjerr jashtë vetëm thumbin dhe kur mundet të thumbojë dikë, ai e bën pa u diktuar. Kështu është edhe bidatçi: ai futet mes njerëzve i maskuar dhe rri derisa t'i afrohen njerëzit. Dhe kur ai e shikon se ata janë mbledhur rreth tij, atëherë ai fillon ta përhapë bidatin e tij."

Ibnul-Xheuza ka thënë: "Heretikët e Islamit ishin tre: Ibnur-Rauendi, Ebu Hajjan et-Teuhidi dhe Ebul-'Ala el-Mu'arri. Më i keqi nga ata për Islamin ishte Ebu Hajjani, sepse dy të tjerët ishin të qartë (në devijimin e tyre) kurse ai ishte i fshehur dhe i pakapshëm." *Sijer A'lamin-Nubela* (17/120).

Veprat që la pas Shejkh Mukbili:



Shejkh Mukbili, Allahu e mëshiroftë la pas mjaft vepra, pjesa më e madhe e të cilave janë dorëshkrime. Ai ka shkruajtur në fusha të ndryshme të dijes, si në hadith, fik'h, akijde... etj. Ai ka shkruajtur gjithashtu edhe libra me refuzime kundër njerëzve të bidatit dhe sekteve të humbura. Ka lënë pas vetes edhe disa përmbledhje me fetvatë e tij. Më poshtë janë renditur titujt e librave të Shejkh Mukbilit:

- 1 - *et-Tali'atu fij er-Radij ala Gulatish-Shij'a*,
- 2 - *Tabrrimul-Khidabi bis-Senad*,
- 3 - *Sher'aijetu Salati fij Niali*,
- 4 - *es-Sahijbul-Musned min Esbabin-Nuzul*,
- 5 - *Haulel-Kubetil-Mebnije 'ala Kabri Rasuli (ﷺ)*,
- 6 - *Tabkijk ue Dirasetil-Ilzamati ue Tetebu'i li Darakutni*,
- 7 - *Tabkijk ue Takbrijxh Muxheledejn min Tefsir Ibn Kethir ila Eueli Suratin Ma'ide*,
- 8 - *es-Sahijbul-Musned mimma lejse fij Sahihejn*,
- 9 - *es-Sujuful-Batira li Ilhadi Shuju'ijetil-Kafira*,
- 10 - *el-Mekbraxh minel-Fitne*,
- 11 - *Irshadu Dhe'uul-Fitan li 'Ibadi Gulati Rauafid minel-Jemen Ta'likatun 'ala Risaletil-Uazjeti lil-Mu'tedin*,
- 12 - *es-Sahijbul-Musned min Dela'ili Nubuwe*,
- 13 - *el-Ilhadul-Khumejni fij el-Erdil-Haramejni*,
- 14 - *el-Xhami'us-Sahijb fij el-Kader*,
- 15 - *Hadidhi Da'uetuna ue Akijdetuna*,
- 16 - *Rudud Ehlil-Ilmi 'ala Ta'inine fij Hadithi Sibr*,
- 17 - *el-Xhem'u bejne Salatejni fij Sefer*,
- 18 - *Kurratul-Ajni fij Exhuibeti Ka'idil-Alabi ue Sahibil-'Udejni*,
- 19 - *el-Feuakihul-Xhenije*,
- 20 - *el-Musara'ah*,
- 21 - *Kam'ul-Mu'anid ue Zexhrul-Hakidi Hasid*,
- 22 - *el-Kaulul-Emin fij Bejani Fada'ih el-Mudhebdhebin*,

- 23 - *el-Xhami'us-Sahijh mimma lejse fij Sahihejn,*
- 24 - *Ixhabetus-Sa'il 'an Ehamil-Mesa'il,*
- 25 - *Ehadithi Mu'eletu Dhabiruha es-Sihatu,*
- 26 - *Mektelu Shejkh Xhemili-Afgani (rahimehullah),*
- 27 - *Garatul-Eshritati 'ala Ehli-Xhebli ues-Sefsetati,*
- 28 - *Tetabu'u Euhamil-Hakim fij el-Mustedrak eletij lem Junebih alejha edh-Dheheb me'a Te'raxhimi li Rru'ati eledhijne lejsu min Rrixhali et-Tehdhijb,*
- 29 - *Tuhfetush-Shabij er-rabbani fij Rad 'ala el-Imam Muhamed Ibni 'Ali esh-Sheukani fij she'niul-Istimna'i,*
- 30 - *Garratul-Fesli 'alel-mu'tedine 'ala Kutubi el-Ilel,*
- 31 - *Idahu el-Mikali fij Esbabiz-Zilzali,*
- 32 - *'Ilalun-Nikiri 'ala as'habi 'Idil-Gadiri,*
- 33 - *el-Kauij fij Dimag es-Sauij,*
- 34 - *Iskat el-kelb el-'au, Jusuf ibn 'Abdilah el-Karadani,*
- 35 - *Nashr as-Sahife fi Dhikr es-Sahib min Akual E'immetul-Xherhi uel-Ta'dil fi Ebi Hanife,*
- 36 - *el-Muktarah fij 'Ilmil-Mustalah,*
- 37 - *esh-Shefa'atu,*
- 38 - *Rijadul-Xhenneti fij Radi 'ala Ada'is-Sunneti.*

Vajza e tij A'isha (Umm 'Abdullah el-Ua'dija) thotë se ai ka edhe disa libra të tjerë të cilët janë ende të pabotuar.

Fjalët e paharrueshme të Shejkh Mukbilit:



Për dijen:

“A ka gjë më të mirë sesa dija? Ajo është më e mirë se ari dhe paratë, më e mirë se një grua e bukur dhe e mrekullueshme dhe më e mirë sesa lukset mbretërore.”

“Do të kërkojmë dije insha`Allah derisa të vdesim.”

“O bijtë e mi, betohem në Allahun se sikur dija të derdhej në gotë, unë do ta kisha derdhur në të që ju ta merrnit, por ajo nuk arrihet përveç se duke u përballur me vështirësi, rraskapitje dhe këputjen e gjunjëve. Jahja Ibn Ebi Kethir i tha të birit të tij, ‘Abdullahut: Nuk arrihet dija me rehatinë e trupit.”

“Përpikuni sa më shumë që të jetë e mundur (në kërkimin e dijes) përpara se të ndaleni ose përpara se të dalë ndonjë pengesë midis jush dhe dijes, sepse vërtet pengesat dhe barrierat janë të shumta.”

“Prej shkaqeve që të ndihmojnë në kërkimin e dijes janë:

1- Frika ndaj Allahut, **“O ju që besoni, nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë një shenjë dalluese (furkan)”** që të bëni dallim midis të vërtetës dhe të pavërtetës, midis bidatit dhe Sunetit, midis dijes së dobishme dhe dijes së padobishme, etj. Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe kijeni frikë Allahun dhe Ai do t’ju mësojë juve...”**

2- T’i mbështetesh Allahut për rrizkun derisa kjo të mos largojë nga kërkimi i dijes.

3- Vendosmëria.

4- Shoqërimi me ata që janë të zellshëm dhe dobiprurës.

5- Qëndrimi larg telasheve.

6- Leximi i biografive të Selefëve.

7- Ruajtja e shëndetit që të ndihmon në mësimin përmendësh të Kur'anit. Kurse sëmundja ju bën që t’i harroni disa gjëra që i keni mësuar.”

“Ajo që ndihmon në mësimin përmendësh është ngrënia e gjërave të ëmbla të cilat çlirojnë nxehtësi, siç janë hurmat, stafidhet, temjani dhe pirja e xhenxhefilit dhe mjalutit. Dhe po të pish më shumë xhenxhefil (sesa normalja) kjo e dëmton gjakun dhe e hollon atë... Zuhriu dhe Muhamed bin Kasim el-Anberi nuk i hanin mollët për shkak të acidit që përmbajnë dhe nga frika se mos u dëmtohej kujtesa.”

“Prej suneteve që këshillohen për fëmijën e porsalindur është ‘Akijka (prerja e kurbanit), pastaj zgjedhja e emrit dhe zgjedhja e mëndeshës (gjidhënësja)... dhe kini kujdes nga thithja e qumështit nga gruaja pa intelekt ose e marrë, sepse qumështi ndikon (tek fëmija).”

Për Teuhidin:

“Pasi ta duan, ta mësojnë dhe ta kuptojnë Teuhidin, ata nuk kanë për t’iu nënshtruar askujt tjetër veç tij. Kështu që pasi t’i kenë pastruar vetet e tyre nga Shirku, Teuhidi do të jetë i lehtë për ta dhe ata do të jenë më të zellshëm për t’i pastruar vetet e tyre nga gjërat e tjera.”

Për kushtimin e rëndësisë ndaj Akijdes:

“Të dhënit rëndësi Akijdes është jashtëzakonisht e domosdoshme. Muslimani pa Akijden e tij nuk mundet t’u bëjë ballë armiqve të tij dhe as nuk mund të sillet sipas normave Islame. Prandaj Pejgamberi ynë, Muhamedi (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) filloi me Akijde dhe e gjithë jeta e tij vërtitej rreth thirrjes drejt Akijdes, vendimeve fetare dhe veprave që kanë të bëjnë me të.”

Për prishjen e qetësisë dhe sigurisë së Muslimanëve dhe frikësimitin e tyre:

Në një prej mësimave të tij, ai lexoi hadithin e Ibn ‘Umerit: “*Jam urdhëruar që t’i luftoj njerëzit derisa ata të dëshmojnë se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut, ta falin Namazin dhe ta japin Zekatin. Nëse e bëjnë këtë atëherë gjaku dhe pasuria e tyre janë të ruajtur nga unë përveç atëherë kur është me të drejtë nga Islamit dhe llogaria e tyre do të jetë tek Allahu.*” Ai u ndal tek ky hadith dhe tha: “Tek ky hadith është refuzimi për disa grupe në kohët moderne. Prej tyre është Xhemati Tekfir që e konsiderojnë hallall gjakun e Muslimanëve, prej tyre është Xhemati Xhihadit që e konsiderojnë hallall gjakun e Muslimanëve, i konsiderojnë prijësat qafira kurse popullin në përgjithësi e konsiderojnë Muslimanë, prandaj infrastruktura e shtetit duhet të shkatërrohet nga Muslimani i papërgjegjshëm; dhe prej tyre janë revolucionarët që u mësojnë njerëzve revolucionin dhe përmbysjen e qeverive.”

Për bidatçijtë:

Ai është pyetur: “A lejohet të shkosh në xhenazet e bidatçijve, nëse bidatet e tyre nuk arrijnë gradën e kufrit?” Ju e keni vetë në dorë nëse do të shkoni apo jo. Sidoqoftë, gjëja më e mirë është që të mos shkosh sepse nuk është bërë e

njohur nga Selefët, Allahu pastë mëshirë për ta, që ata të kenë shkuar në xhenazet e bidatçijve. Madje Imam Ahmedi ka thënë, “Midis nesh dhe atyre janë xhenazet”, d.m.th. mos shkoni në xhenazet e tyre.”

“Ibn Tejmije dhe Ahmed bin Hanbel e konsideronin refuzimin e njerëzve të bidatit si një nga veprat më madhështore që të afrojnë tek Allahu ‘*Azze ue Xhel*. Madje ky është Xhihadi më i mirë. Dhe vërtet, është thënë për Muhamed bin Isma’il es-San’ani se ai u sëmur me diarre. Ai kishte një libër të një bidatçiu dhe tha: “Digjeni këtë libër dhe me të piqu bukën time.” Ata vepruan ashtu, dhe ai hëngri bukën e pastaj Allahu e shëroi nga sëmundja që vuante.”

Për Ikhuatul-Muslimin:

“Mos mendoni se personi që është nga Ikhuatul-Muflihin²⁴ (Vëllezërit e Falimentuar) ka ndonjë shenjë në fytyrën apo ballin e tij ose ndonjë shenjë në dorën e tij apo në mënyrën se si ai qesh. Jo, jo! Ajo (Ikhuanija) është veçse një ideologji.”

“Ata thonë: Pse ju paralajmëroni kundër librave të Muhamed Sururit dhe Sejjid Kutbit dhe nuk paralajmëroni kundër librave të Ibn Haxherit dhe Neveviut edhe pse ata kanë gabime në Akijde?” Këto fjalë të bëjnë që të vdesësh së qeshuri!!!”²⁵

Për Xhematin Tablig:

“Në të vërtetë ata kanë nevojë për vetet e tyre për *tablig* (d.m.th. vetë ata kanë nevojë për predikim).”

Për Xhematul-Xhihad:

“Jemeni besoi në mesazhin (e Islamit) dhe ‘Ali bin Ebi Talib, Khalid bin Uelid, Ebu Musa el-Esh’ari dhe Mu’adh bin Xhebel u dërguan në Jemen, prandaj ne nuk kemi nevojë për *Xhematul-Fesad* (Xhematin e Shkatërrimit).”²⁶

²⁴ Kështu i quante Ikhuatët Shejh Mukbili, Allahu e mëshiroftë.

²⁵ Në një rast tjetër Shejh Mukbili ka thënë: “Pejgamberi (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “Nëse nuk ke turp, atëherë bëj si të të vijë për mbarë.” Dhe unë nuk mendoj se dikush do të merrte guximin që ta barazojë Sejjid Kutbin me el-Hafidh Ibn Haxher, ai i cili i shërbeu Sunetit në mënyrë të pashembullt. Libri i tij *Fet’hul-Bari* është konsideruar thesar i diturisë dhe ai konsiderohet poashtu si një bibliotekë më vete...”

²⁶ Kështu i quante Shejh Mukbili *rahimebullah* grupin e njohur si *Xhematul-Xhibad* për shkak se ata nuk sollën kurrëfarë mirësie për Umetin Islam përveç rrënimit dhe shkatërrimit.

“Gjahu i *Xhematul-Fesad* janë ata që kanë entuziazëm (për Fenë) por nuk kanë dije.”

Për Bin Ladenin:

“Unë e distancoj veten time nga Usama bin Laden. Ai është një fatkeqësi dhe një fitne për Muslimanët dhe veprimet e tij janë të liga.”²⁷

Për Hizbijen:

“Unë nuk do të rri i heshtur para tyre në asnjë mënyrë, përveç kur ata t'i kthehen Sunetit, madje edhe sikur ata të botojnë një mijë libra kundër nesh, ngaqë ne e dimë që jemi në *Hak* (në të Vërtetën) kurse ata janë në *Batil* (në të Kotën, të Pavërtetën)...”

“Hizbi është ai që thërret për në ideologjinë e tij. Edhe nëse ai thërret për në Kur'an dhe Sunet, ai thjesht vetëm se po e fsheh atë (ideologjinë e tij). Hizbija nuk ka ndonjë bri. Ajo është thjesht ideologji.”

“Hizbijet o vëllezërit e mi janë të këqinj. Ata po përgatiten që të marrin në dorë qeverinë sa më shpejt që t'u jepet mundësia. Prandaj është e rëndësishme që të mos i lejojmë ata, të mos i ndihmojmë në asnjë nga mashtrimet e tyre, përveçse në aspektin e bindjes së tyre, nëse dihet se ata do të pendohen.”

²⁷ I ka thënë këto fjalë Shejkh Mukbili aty nga viti 1998 kur ende nuk kishte plasur e ashtuquajtura “Lufta kundër Terrorizmit”, luftë e cila në fakt ishte kundër Muslimanëve dhe Islamit dhe ditët që pasuan njëra-tjetrën e dëshmuar këtë gjë. Për rrjedhojë, u pushtuan tokat e Muslimanëve, u derdhën lumenj gjaku, u nëpërkëmb nderi i Muslimaneve, u vodhën dhe u shfrytëzuan pasuritë e tyre në mënyrë barbare dhe mbi të gjitha u përdhos Shenjtëria e Fesë Islame nëpër media e gazeta dhe u përqesh i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu alejhi ue sel-lem*) nga armiq të kësaj feje. Padyshim që Miti Bin Laden ka patur një impakt të jashtëzakonshëm në zhvillimin e ngjarjeve dhe ky ishte ai që shërbeu si katalizatori i ndezjes së urrejtjes kundër Muslimanëve dhe nisjen e kryqëzatave kundër tyre. Shejkh Mukbilin e kanë akuzuar si një klerik radikal i cili frymëzonte luftën e shenjtë kundër botës perëndimore, i cili kinse ishte i lidhur me lëvizjet aktuale të Xhihadit. Por në të vërtetë ato ishin veç shpifje me anë të së cilave kërkohet që të diskreditohej Instituti i Shejkhut në të cilin nuk predikohej asgjë tjetër përveç Islamit autentik sipas kuptimit të pararendësve tanë të mirë (Selefus-Salih). Vërtet fjalët që ai ka thënë për Bin Ladenin dëshmojnë për dijen e thellë dhe largpamësinë, mosngutjen dhe racionalitetin e tij duke mos u emocionuar nga ngjarjet e bujshme dhe bëmat e hizbijes së Bin Ladenit dhe të ngjashmëve si puna e tij. I vetmi rezultat që solli Bin Ladeni mbi kurrizin e Muslimanëve ishin fitnet dhe fatkeqësitë e njëpasnjëshme dhe asnjë gram hajri edhe pse ndonjë injorant mund të mendojë se ai ka luftuar për Muslimanët.

“Ju duhet të shkoni pas dijes së dobishme dhe kini kujdes, kini kujdes e mos u zini besë njerëzve të Hizbijes. Mund t’ju vijë ndonjë person e t’ju thotë: “Unë s’jam Hizbi; Betohem në Allah se gaboheni nëse thoni për mua që jam Hizbi.” Po, e ndoshta ju do ta besoni atë, por ata janë njerëz që s’e kanë problem që të betohen rrejtshëm. O vëllezërit tanë, ata nuk e vrasin mendjen fare për këtë. Akoma ka disa njerëz presin t’u vijë hizbiu me dy brirë si brirët e demit! Por, hizbija është hizbije. Ajo është ideologji. Është një ideologji që lë gjurmë të këqia në mendje, pastaj ai (hizbiu) thërret për tek ajo (ideologji) dhe i përçan Muslimanët. Po!”

“Është e domoshdoshme që të bësh dallim për sa u përket njerëzve të dijes. Kushdo që ka Akijden e tyre, e cila është Teuhidi, atëherë ai duhet respektuar. Dhe kushdo që ka Akijden e Bidatit dhe Hizbijes nuk duhet respektuar.”

“Ai që e rruan mjekrrën është i pabindur dhe i pabinduri është *fasik* (gjynahqar i hapur). Dhe nëse ai është i drejtë në Sunet, atëherë ai nuk del nga rradhët e Ehli-Sunetit për shkak të kësaj veprë dhe ai është shumë herë më i mirë sesa hizbiu.”

“Sufistët, Shijat dhe Hizbitë janë të këqinj në vetvete dhe ata kanë nevojë për ndryshim. Prandaj mos prisni largimin e të keqes nga ata sepse me të vërtetë ata janë të këqinj në vetet e tyre.

“Njerëzit e Nexhdit dhe ata që janë në tokat e dy Xhamive të Shenjta nuk e njohin Hizbijen ashtu siç po e përjetojmë ne. Prandaj Ibn Xhibrini na dërgon telegrame që ne të bashkëpunojmë me Hizbitë. Edhe ne kështu ishim më përpara, nuk e njihnim Hizbijen. Dhe kur ajo na i zuri frymën dhe na mbërtheu nga kokat tona, ne u detyruam që të flisnim kundër saj.”

Për Selefizmin:

“Selefizmi nuk është xhybe që vishet...”

“La Hizbije fii Da’uetus-Selefije! - Nuk ka hizbije në Dauetin Selefij!”

Për rregullin: Ne bashkëpunojmë në atë që pajtohemi dhe e justifikojmë njëri-tjetrin në atë që kemi mosmarrëveshje:

“Tek ky rregull është mohimi i argumenteve që lidhen me urdhërimin e të mirës dhe ndalimin e të keqes dhe ai që e thotë këtë është Munafik (dyfytirësh) që ka rënë në hipokrizinë e veprave.”

Për kapjen pas Sunetit:

“Ne nuk do ta braktisim kurrë Sunetin e të Dërguarit të Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) edhe sikur të na kafshojnë me dhëmbë egërsisht dhe mizorisht.”

Për Ehli-Sunetin:

“Ehli-Suneti lavdi Allahut i kanë mbyllur shtigjet dhe armiqtë e Islamit janë frikësuar nga ata. Amerika është përgatitur që t'i ndihmojë Sufistët, Shijat dhe Qafirat kurse Ehli-Sunetin jo.”

Për hipokrizinë:

“Ai që nuk i frikësohet hipokrizisë për veten e tij është i mashtruar dhe i verbër.”

Për arrogancën dhe mendjemadhësinë:

“Personi arrogant dhe kryeneç është i urreyer mes njerëzve edhe sikur ai t'u jepte atyre shporta me flori.”

Ai ka thënë gjithashtu: “Mendjemadhësia është një gjë që të largon nga mirësia. Allahu ka thënë:

سَأَصْرِفُ عَنْ آيَتِيَ الَّذِينَ يَتَكَبَّرُونَ فِي الْأَرْضِ

“Unë do t'i largoj nga Ajetet e Mia (Vargjet e Kur'anit) ata të cilët do të sillen me kryelartësi në tokë.”²⁸

Dhe ai që ka mendjemadhësi është i urreyer nga njerëzit edhe sikur të ketë ar në sasi të mëdha.”

²⁸ A'raf, 146.

Për bojkotimin që po ndodh sot mes Selefive:

“Bojkotimi në këtë kohë ashtu si edhe në kohë të tjera nuk duhet të jetë i bazuar në epshe. Ka një përplasje midis teje dhe shokut tend dhe ti thua: “Unë do ta bojkotoj atë për hir të Allahut.” Por nëse do ta shohësh edhe një herë në veten tënde me drejtësi, do të shohësh se ti e ke bojkotuar atë vetëm për hir të interesave të t’ua personale. Dhe bojkotimi për hir të Allahut *Subhanehu ue Te’ala* nuk është që ti të bojkotosh duke u bazuar në interesat e tua personale.”

Për Da’uen:

“E kemi detyrë që t’i frikësohemi Allahut për sa i përket Da’uetit dhe të mos e kundërshtojmë atë duke e nënvlerësuar.”

“Da’ueti dhe Akideja jonë janë më të dashura për ne sesa vetet tona, pasuritë dhe fëmijët tanë. Kështu që ne nuk jemi përgatitur që të heqim dorë nga ato as për ar e as për argjend. E themi këtë në mënyrë që askush të mos shpresojë se do ta blejë Da’uetin tonë dhe as të mendojë se mundet që ta blejë atë nga ne me dinarë apo me dirhem. Për shkak se politikanët tashmë e dinë këtë gjë për ne, prandaj ata i kanë humbur shpresat se mund të na i blejnë duke na ofruar pozitë dhe pasuri.”

“Gjëja të cilës i frikësohemi më së shumti për da’uetin tonë janë vetet tona dhe gjynahet tona. Allahu i Lartësuar thotë:

وَمَا أَصْبَكُمْ مِنْ مُصِيبَةٍ فَبِمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُوا عَنْ كَثِيرٍ ﴿٣٠﴾

“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; por Ai fal shumë.”²⁹

“Janë gjynahet ato që i kanë poshtëruar Muslimanët, prandaj ata e kanë detyrë që të nxjerrin mësim nga e kaluara e tyre.”

“Pasha Allahun, ne nuk frikësohemi për dauetin tonë përveç se nga vetet tona.”

²⁹ Shura, 30.

Vdekja e tij:



Shejkh Mukbil bin Hadi el-Uadi'i ndërroi jetë në datën 2 të muajit Xhumadel-Ula, 1422H (21/7/2001) për shkak të një sëmundjeje në mëlçi nga e cila vuante për një kohë të gjatë.

Gjatë fundit të jetës ai udhëtoi për t'u kuruar nga kjo sëmundje e rëndë në Amerikë, Gjermani dhe së fundi në Arabinë Saudite, por pa rezultat. Ai ndërroi jetë në spitalin ku ishte shtruar në Xhidde. Namazi i Xhenazes iu fal në Mekke dhe ai u varros në varrezat *el-'Adl* pranë varrit të Shejkh Ibni Bazit dhe Shejkh Ibn 'Uthejmin, Allahu i mëshiroftë ata që të tre.

Vërtet, vdekja e Shejkh Mukbilit ishte një fatkeqësi që e pllakosi Umetin e Muslimanëve në një kohë kur fitnet po shtoheshin dhe grupet e bidatit dhe dalaletit filluan të lulëzonin menjëherë pas vdekjes së tre Imamëve të pazëvendësueshëm të kësaj Feje: Imam Albani, Imam Ibni Bazi dhe Imam Ibnul-'Uthejmini, Allahu i mëshiroftë që të gjithë ata. Zinxhirit të tyre iu shtua edhe një luftëtar i paepur i Fesë së Allahut i cili me fjalët dhe bojën e tij sqaroi të vërtetën nga e pavërteta dhe i nënshtroi njerëzit e përçarjes dhe lajthitjes. Ishte Shejkh Mukbili ai i cili e përhapri Selefizmin në të gjithë Jemenin në një kohë kur Jemeni ishte shkretuar nga Shi'izmi në pjesën veriore të tij dhe sufizmi në jugun e tij. Ndërsa sot Jemeni vezullon nga Thirrja Selefije dhe numri i pasuesve të Sunetit është shtuar në mënyrë marramendëse.

Allahu e pranoftë Shejkh Mukbilin në Mëshirën dhe Kënaqësinë e Tij dhe e bashkoftë atë me shoqërinë e njerëzve më të zgjedhur: me Pejgamberët, Sahabët, Shehidët dhe të Devotshmit.

Ne i lutemi Allahut *'Azzë ue Xhel* që t'i ruajë Ulematë tanë e ta vazhdojë mirësinë e tyre dhe t'i shtojë njerëzit e përkushtuar që do ta marrin përsipër këtë Dauet të bekuar. I lutemi Allahut *'Azzë ue Xhel* që të nxjerrë thirrësa të singertë e të palëkundur për trojet Shqiptare, në mënyrë që errësira e Shirkut, Kufrit, Bestytive, Bidateve, Injorancës dhe Hizbijes të çirret nga drita e Teuhidit, Imanit, Sunetit, Dijes së Pastër Sheriatike dhe Unitetit të Zembrave në Fjalën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*). Thirrësa të tillë si Shejkh Mukbili. Amin!

Vërtet, sa shumë e ndjejmë mungesën e thirrësave të tillë në vendin tonë!

Fjalët e Ulemave për Shejkh Mukbilin:



Fjalët e Imamit, Muhadithit të Kohës, Muhamed Nasirud-Din el-Albani (Allahu e mëshiroftë):

“...Sa u përket atyre njerëzve të cilët kanë dije rreth kësaj shkence, ata nuk kanë ndonjë dyshim për dobësinë e këtij hadithi. Ne kemi Shejkh Mukbil bin Hadi, Jemenasin i cili ka përmendur në verifikimin e tefsirit të Ibn Kethirit (vëllimi 1, fq. 513) pasi flet shkurtimisht rreth transmetuesve të zinxhirit një nga një: - Hadithi është i dobët për shkak të shkëputjes në zinxhir dhe për shkak të dobësisë së ‘Ubejdullah bin Uelid er-Rasafi.”³⁰

Shejkhul-Albani është pyetur për Mukbil bin Hadin dhe Rabij' bin Hadi el-Medkhalij dhe është përgjigjur:

“Padyshim që ne e falenderojmë Allahun ‘*Azze ue Xhel* që ka siguruar për këtë Dauet të drejtë që ngrihet mbi Kur'an dhe Sunet dhe mbi metodologjinë e Selefus-Salih, shumë thirrësa për në Islam në vende të ndryshme Islame të cilët e zbatojnë detyrën që nuk po zbatohet vetëm se nga shumë pak njerëz në botën Islame sot.

Prandaj këta dy shejkha janë një bekim, dy thirrësa për tek Kurani dhe Suneti dhe rruga që kanë ndjekur Selefus-Salih, (dy thirrësa) të cilët luftojnë kundër atyre që i kundërvihen këtij Menhexhi të saktë. Siç e dinë të gjithë se kjo (luftë që po bëhet kundër Shejkh Mukbilit dhe Shejkh Rabisë) padyshim buron nga dy lloj njerëzish; ose nga një njeri i paditur ose nga një njeri që ndjek epshin e tij. Sa për personin injorant, atëherë është udhëzimi i tij është i lehtë sepse ai mendon se ka dije, kështu që kur atij i shpjegohet dija e saktë ai udhëzohet.

Për këtë arsye unë e kam thënë në mjaft raste se shumë nga organizatat që janë përhapur sot edhe pse ato kanë devijuar nga Daueti ynë, ne gjejmë mes tyre ata që kanë sinqeritet – i cili është më i dashur për mua sesa disa prej atyre që janë në Dauetin tonë, ndonëse është e qartë se ata nuk bashkohen me ne në sinqeritetin i cili është një kusht për pranimin e të gjitha veprave të mira.

³⁰ *Silsiletu-Daife*, vëllimi 5, fq. 95.

Kurse për sa i përket atij që ndjek epshin e tij, atëherë ne nuk kemi rrugëzgjidhje tjetër për të përveç që Allahu *Tebarake ue Te'ala* ta udhëzojë. Pra, ata që i kritikojnë këta dy shejha janë siç i përmendëm, ose injorantët - dhe ata duhet të edukohen - ose ai që ndjek epshin e tij. Dhe në këtë rast Allahut na ruajt nga e keqja e këtij personi dhe ne i kërkojmë Allahut që ta udhëzojë ose përndryshe t'ia thyejë shpinën.

Për sa i përket Shejkh Mukbilit, unë nuk kam lexuar shumë nga veprat e tij, ndryshe nga vëllai ynë Rabi'. Ajo që duket nga pamja e jashtme është se Rabi' është më aktiv në të shkruajtur sesa Shejkh Mukbili ³¹ dhe anasjelltas në Da'ue, (Shejkh Mukbil është më i angazhuar në) përzierjen me njerëzit dhe ftimin e tyre tek Kur'ani dhe Suneti duke i këshilluar ata dhe duke i drejtuar më shumë sesa Shejkh Dr. Rabi'.

Kurse Shejkh Mukbili, atëherë njerëzit e Mekkes i njohin kullotat e tyre më mirë – lajmet që na mbërrijnë nga ju janë dëshmia më e mirë se Allahu e ka begatuar atë me aftësi që ndoshta është e pashembullt nëse do të krahasohej me disa nga ata që thirrasin në Islam sot në faqen e tokës. **Kështu që, ne i lutemi Allahut Azze ue Xhel që t'u japë Muslimanëve aftësinë që t'ua pranojnë (këtyre dy Shejhave) fenë e tyre dhe se ata janë të pastër nga ndjekja e epsheve.**³²

Fjalët e Fekihut, Imami, Shejkh 'Abdul-'Aziz bin Baz (Allahu e mëshiroftë):

Dikush e ka pyetur Shejkh Bin Bazin se ku duhet të shkonte të merrte dije në Jemen dhe Shejkh u përgjigj: “Shko tek Shejkh Mukbili.”

Kur Shejkh Bin Bazi ka folur rreth historisë së Daueit në Jemen, ai ka thënë: “Ky është rezultati i fryteve të ndershmërisë dhe sinqeritetit.”

³¹ Shejkhul-Albani e ka këshilluar Shejkh Mukbilin që t'i kushtonte më shumë vëmendje shkruajtjes së librave, por për shkak të impenjimit të madh në studime dhe mungesës së kohës që kishte, Shejkh nuk ka shkruajtur aq shumë libra sikurse Shejkh Rabi' Ibn Hadi el-Medkhalij. Por kjo nuk do të thotë se numri i vogël i librave është një tregues i sasisë së vogël të dijes që ka autori! Absolutisht! Mes dijetarëve ka patur të atillë që zotëronin një dituri mjaft të gjerë dhe të mahnitshme, por megjithatë veprat e tyre numëroreshin me gishtat e njërës dorë, për arsye se ata kanë qenë të preokupuar me da'ue, mësimdhënie, refuzimin e bidatçijve, ibadet etj.

³² *Silsiletul-Huda uen-Nur*, n. 851, Datë 9/7/1416.

Shejkh Mukbili ka treguar se një person shkoi ilegalisht në Rijad dhe i tha Shejkh Bin Bazit: “O Shejkh unë jam nga Ehli-Suneti por nuk kam ndonjë dokument.” Shejkh Bin Bazi i tha: “Ma vërteto që je nga Ehli-Suneti.” Ai nxorri një letër me nënshkrimin tim dhe kur Shejkhu e pa, ai i shkroi një letër me të cilën ai mund të udhëtonte ku të donte.³³

Shejkh Bin Bazi ka thënë gjithashtu: “Shejkh Mukbil është më i ditur se unë ngase ai është një Muhadith.” [Këto fjalë burojnë nga modestia e Shejkh Bin Bazit, Allahu e mëshiroftë.]

Fjalët e Fekihut, Shejkh Muhamed Ibn Salih el-'Utnejmin (Allahu e mëshiroftë):

Shejkh Muhamed Ibn 'Utnejmin, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Thojini atij se unë e konsideroj si muxhedid të Islamit.”³⁴

Fjalët e Shejkh Rabi' bin Hadi el-Medkhalij:

Shejkh Jahja el-Haxhuri ka transmetuar se Shejkh Rabi' el-Medkhalij ka thënë për të: “Ai është muxhedidi i tokave të Jemenit” dhe ka thënë gjithashtu: “Nuk mund të gjendet asnjë njeri që nga koha e ‘Abdu-Rrazzak es-San’anit³⁵ e deri në ditët e sotshme që ta ketë ngritur dhe ringjallur Dauetin si el-Uadi'i (Shejkh Mukbili).”³⁶

³³ *Ratha Shejkbinal-Ibni Baz* fq. 16.

³⁴ *Nubdha Mukhtesira*, fq. 9.

³⁵ Ai është një nga Muhadithët më të mëdhenj që ka njohur Jemeni. Lindi në vitin 126 Hixhrij dhe mësuesit e tij ishin Imam Malik, Euza'ij, Sufjan eth-Theuri, Sufjan Ibn Ujejne etj. Ai është autor i librit të famshëm *el-Musannef* në të cilin janë përmbledhur hadithe Pejgamberike dhe thënie të Sahabëve. Prej atyre që kanë marrë dije prej tij numërojmë Imam Ahmed Ibn Hanbel, Jahja Ibn Me'in, 'Ali Ibnul-Medini, Is'hak Ibn Rahauejh etj. Imam Ahmedi ka pas thënë për të: “Askush nuk është më i ditur në shkencën e hadithit sesa ‘Abdur-Rrazaku.” Vdiq në vitin 211H, Allahu e mëshiroftë. Prej këtu kuptojmë pozitën e madhe që ka pas Shejkh Mukbili mes Ulemave Selefijin të këtij Umeti dhe vlerat e tij si një Dijetar i pashembullt në këtë kohë që po jetojmë. Dhe fjalët e Imamit të Xherhit dhe Ta'dilit, Shejkh Rabi' Ibn Hadi el-Medkhalij, i cili e ka rradhitur atë me dijetarë të tillë si ‘Abdu-Rrazzaku, përbëjnë dëshminë më të qartë për dijen dhe mirësinë që kishte Shejkh Mukbili, Allahu e mëshiroftë.

³⁶ *Nubdha Mukhtesira*, fq.9.

Ai ka thënë gjithashtu në këshillën e tij për Selefite e Jemenit dhe në poezinë që recitoi në vajtim për Shejkh Mukbilin në vitin 1/5/1422:

“Kjo është ajo që shprehim si ngushëllim për bajraktarin e Sunetit dhe Teuhidit, thirrësin për tek Allahu, ringjallësin e vërtetë në tokën e Jemenit. Rezultatet e Dauetit të tij mbërritën në shumë vende të tokës. Po ju them atë që besoj se vendi juaj pas brezave më të mirë u njoh me Sunetin dhe Menhexhin e Selefus-Salih. Suneti u shfaq në periudha të ndryshme kohore me forcë, por akoma nuk njoh ndonjë periudhë si kjo me të cilën Allahu u ka begatuar ju dhe popullin e Jemenit me duart e këtij njeriu të mirë, Muahdithi, Zahidi, i Devotshmi që e shkeli dynjanë dhe bukuritë e saj me këmbët e tij.”³⁷

Shejkh Rabi' tha gjithashtu ndërkohë që po i përcillte ngushëllimet e tij Shejkh Jahja el-Haxhurit për vdekjen e Shejkh Mukbilit, Allahu e mëshiroftë:

“Allahu ua shtoftë shpërblimin dhe u dhëntë ngushëllimet më të mira, Ai e faltë të vdekurin tuaj. Allahu e jep dhe e merr atë që është e Tij dhe çdo gjë ka një kohë të caktuar. Ky është Suneti i Allahut *Tebarake ue Te'ala*, lavdi Allahut.

Unë i lutem Atij që ta mbulojë këtë njeri me mëshirën e Tij dhe të jetë i kënaqur me të. Ky zahid, i devotshmi të cilin unë e konsideroj si muxhedid në kohën tonë, prej muxhedidëve të Islamit. Allahu pastë mëshirë për të. Ai kishte marrë përsipër vazhdimin e Dauetit dhe ai e çoi deri në fund përgjegjësinë, u bëri ball vështirësive dhe mundimeve që ka Daueti me durim, zuhd dhe devotshmëri. Të gjitha këto e ndihmuan atë në përhapjen e Dauetit të tij dhe ngritjen e pozitës së tij - inshaAllah - tek Zoti i tij dhe tek Muslimanët.³⁸

Është detyrë për studentët e tij që të vazhdojnë rrugën e Pejgamberit fisnik (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) në dritën e Kur'anit dhe Sunetit dhe Menhexhin e Selefus-Salih, në veprat e Menhexhit të këtij burri që e keni parë me sytë tuaj, e dëshmuat dhe e njohët personalisht.

³⁷ *el-Abhaxh bi-Terxhimet el-Alame el-Muhadith Ebi Abdu-Rrahman Mukbil bin Hadi el-Uadi'i ue Darul-Hadijth bi-Demexh*, fq. 163.

³⁸ Vlen të përmendim këtu një ngjarje prekëse që lidhet me këta dy dijetarë të nderuar: Kur Shejkh Mukbili mbërriti në Xhidde për për t'u kuruar, aty erdhi edhe Shejkh Rabi' Ibn Hadi el-Medkhalij për t'i bërë vizitë Shejkhut. Kjo vizitë ndodhi pasi ata kishin qëndruar për 22 vjet me rradhë larg njëri-tjetri pas dëbimit të Shejkh Mukbilit nga Saudia në kohën e fitnes së Xhuhejmanit. Kur u takuan, ata u përqafuan me mall dhe Shejkh Mukbili e puthi Shejkh Rabinë në ball, nga dashuria dhe respekti i madh që kishte për të. Ndërsa Shejkh Rabi' shprehu mallëngjimin e tij me dy strofa poetike: “Vërtet, Allahu i bashkon sërish dy njerëz që ndahen, ndonëse ata kishin menduar se kurrë më s'do të takohen.”

Shpresoj që shembulli i tij të ketë qenë një shembull i gjallë për ju që ta ndiqni këtë Fe dhe të kapeni pas saj me devotshmëri, Zuhd dhe me durim kur të përballeni me mundimet për lartësimin e Fjalës së Allahut *Tebarake ue Te'ala* dhe përhapjen e Fesë së Allahut '*Azize ue Xhel*.'³⁹

Fjalët e Muhadithit, Shejkh Ahmed bin Jahja en-Nexhmi (Allahu e mëshiroftë):

Ka thënë Muftiu i Jugut të Arabisë Saudite, Shejkh Ahmed en-Nexhmi *rahimebullah* kur vizitoi institutin Darul-Hadijth në Demaxh (3/Xhumadel-Akhir/1422) me rastin e vdekjes së Shejkh Mukbilit:

“Të gjitha lavdërimet janë vetëm për Allahun për *Kadan* dhe *Kaderin* e Tij. Duhet patur durim medoemos ngase të gjithë njerëzit do të vdesin. Megjithatë, kushdo që lë pas vetes diçka si kjo nuk konsiderohet i vdekur sepse ai ka ngritur diçka, ai ka ndryshuar, ai ka ftuar dhe ka dhënë mundin e tij.

Ne duam që ai të konsiderohet si një nga njerëzit e virtytshëm e të devotshëm, një nga Eulijatë e rangut më të lartë. Kështu e konsiderojmë ne atë dhe Allahu do të na marrë të gjithëve në llogari.

Megjithatë, ne e shohim të gjithë këtë, e shohim krejt me sytë tanë dhe e ndjejmë.

Dhe ne e dimë - lavdi Allahut - se ai ka bërë shumë bamirësi që shumë pak mund ta bëjnë atë që ka bërë ai.

Të gjitha këto qendra mësimore që u ngritën në Jemen janë mirësi e veprave të tij të mira, më saktë nga disa nga veprat e tij të mira. Çdo person që drejton ndonjë nga këto qendra është nga studentët e tij dhe të gjithë ata janë shembull për t'u ndjekur.

Nuk ka dyshim se kush ka nisur diçka të mirë apo ka bërë një punë të mirë dhe kushdo që e ndjek atë punë të mirë, personi që e nisi atë punë të mirë do të ketë shpërblim për atë që bën vetë dhe shpërblim nga ai që vepron me atë punë.

³⁹ *el-Abhaxh bi-Terxhimet el-Alame el-Muhadith Ebi Abdu-Rrahman Mukbil bin Hadi el-Uadi'i ue Darul-Hadijth bi-Demaxh*, fq. 164.

Sikurse ka thënë Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*): “Kush thërret për në mirësi do të shpërblehet dhe do të ketë shpërblimin e atij që vepron me mirësinë që thërret ai. Kush nis një devijim dhe i thërret të tjerët drejt tij, atëherë i tij është gjynahu (i fillimit të devijimit) dhe gjynahu i atyre që veprojnë sipas asj të keqeje.”

Ne i kërkojmë Allahut falje dhe mirësi. Ky tubim që po shohim nuk është tjetër veçse nga veprat e mira të këtij Dijetari të madh i cili thirri për tek Allahu dhe ishte i duruar e i palëkundur.

Ai e sakrifikoi çdo gjë të dashur dhe çdo gjë të vyer për t'i mbledhur bashkë këto fytyra, për t'i inkurajuar ata që të mësojnë dijen dhe ta zbatojnë atë në rrugën e drejtë, në rrugën që Allahut *Subhanehu ue Te'ala* na ka urdhëruar ta ndjekim, sepse Ai thotë:

وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ ذَلِكُمْ وَصَّاكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“Dhe kjo është Rruga Ime e Drejtë, kështu që ndiqeni atë dhe mos ndiqni rrugë të tjera sepse ato do t’ju largojnë nga Rruga e Tij. Kështu ju ka urdhëruar Ai në mënyrë që të bëheni Muttekunë (t’i frikësoheni Atij duke zbatuar urdhërat e Tij dhe duke qëndruar larg nga ndalesat e Tij).”⁴⁰

Lutja jonë e fundit është: lusim Allahum ‘*Azzze ue Xhel* që ta falë të ndjerin tonë dhe të krejt Umetit të pikëlluar, ta falë atë dhe gjynahet e tij.

Ne i lutemi Allahut ‘*Azzze ue Xhel* që ta falë atë dhe gabimet e tij. Jemi plotësisht të bindur insha`Allah se të tilla vepra janë një arsye që Allahu ta falë robin e tij.

Ne i lutemi Allahut që ta falë Shejkh Mukbilin dhe ta na bëjë të mundur që ta ndjekim shembullin e tij në këto vepra të mira dhe në rrugën që ndoqi për Dauetin e saktë për Librin e Allahut, Sunetin e të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe metodologjinë e Selefus-Salih. Ne i lutemi Atij që të na i bëjë të mundur ndjekjen e Menhexhit Selefij, që është metodologjia e Selefëve, Allahu qoftë i kënaqur me ata. Salavatet dhe selami i Allahut qoftë mbi Pejgamberin tonë Muhamed, mbi Familjen dhe Shokët e tij.”⁴¹

⁴⁰ El-En-am, 153.

⁴¹ *el-Abhaxh bi-Terxhimet el-Alame el-Muhadith Ebi Abdu-Rrahman Mukbil bin Hadi el-Uadi'i ue Darul-Hadijth bi-Demaxh*, fq. 164-166.

Fjalët e Shejkh Salih Ibn Feuzan el-Feuzan:

Shejkh Feuzani është pyetur për Akijden e Shejkh Mukbilit dhe është përgjigjur duke thënë: “Po, Shejkh Mukbili – Allahu e mëshiroftë – studioi këtu në këtë vend, në Universitetin Islamik. Ai mësoi Teuhidin dhe shkoi në Jemen. Ai bëri da’ue për Allahun dhe për Teuhid. Daueti i tij është i mirë me sa kam dëgjuar dhe për sa kohë që frytet e atij Daueti vazhdojnë. Allahu e begatoi atë. Allahu pastë mëshirë për të.”

Fjalët e Shejkh Muhamed Ibn ‘Abdul-‘Uhab el-Bena:

“Ai është nga Selefijnët më të mirë, domethënë nuk ka njeri që të ketë patur më shumë ndikim tek studentët dhe vendi i tij sesa Shejkh Mukbili.”

Me të vërtetë I mani dhe Urtësia vijnë nga Jemeni!



Kur Islami u përhap derisa erdhi ndihma dhe ngadhënjimi nga Allahu i Lartësuar, njerëzit filluan të hynin në Fenë e Allahut në turma, e midis tyre ishin njerëzit që vinin nga Jemeni. Pas kësaj dyndjeje të njerëzve për të përqaftuar Islamin, i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dërgoi mësues dhe edukatorë që t'u mësonin atyre Islamin. Ai dërgoi 'Ali Ibn Ebi Talibin (*radij-Allahu 'anhū*) tek fisi Hamdan që gjendet në veri të Jemenit, nga i cili e ka prejardhjen edhe Shejkh Mukbili *rahimebullah*. Ai dërgoi Mu'adh Ibn Xhebelin (*radij-Allahu 'anhū*) në Xhenad, i cili sot është qyteti Ta'izz, ku u ngrit xhamia e parë në Jemen në muajin e parë të vitit të gjashtë Hixhrij. Mu'adhi u dërgua nga Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) që ta thërriste popullin në Islam, që t'i mësonte ata dhe që t'u jepte fetva. Ai kishte gjithashtu funksionin e gjykatësit.

'Abdullah Ibn 'Abbasi (*radij-Allahu 'anhuma*) ka thënë: Kur i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dërgoi Mu'adhin (*radij-Allahu 'anhū*) në Jemen, ai i tha: *"Ti po shkon tek një popull që janë prej Ebli-Kitabëve, prandaj le të jetë gjëja e parë ku do t'i thërrasësh ata dëshmia La ilahe il-LAllah - se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përpos Allahut."*

Ndërsa në një transmetim tjetër qëndron: *"...thirri ata që ta njësojnë Allahun (të vetëm) në të gjithë adhurimin..."*

Në një rast tjetër, në ditën kur u zhvillua beteja e Khajberit, ai (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) i tha 'Ali Ibn Ebi Talibit (*radij-Allahu 'anhū*) kur i dha në dorë flamurin dhe e njoftoi se Allahu do të japë fitoren nëpërmjet duarve të tij: *"Ec përpara ngadalë dhe i qetë derisa të arrish tek ata në pozicionet e tyre. Pastaj thirri ata në Islam dhe njoftoji për obligimet që u ka vendosur Allahu i Lartësuar që janë të Drejtat e Tij. Pasha Allahun! Sikur Ai të udhëzojë me duart e tua veç njërin prej tyre në Islam, atëherë kjo është më e mirë për ty sesa Humrin Na'am"*⁴².

Pra, mësuesit e parë të popullit të Jemenit ishin Shokët më të nderuar të Pejgamberit (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) të cilët ndoqën mësimet dhe udhëzimet e tij, të tillë si Mu'adh Ibn Xhebeli dhe 'Ali Ibn Ebi Talibi (*radij-Allahu 'anhuma*). Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: *"Vërtet Imani është Jemenas dhe*

⁴² *Humrin Na'am* quhen devetë e kuqe të cilat konsideroheshin pasuria më e shtrenjtë për Arabëve atëkohë.

Hikmeja (Urtësia) është Jemenase dhe po e shoh ndihmën (Nefes) e Rrahmanit duke ardhur nga Jemeni.”⁴³

Ibn Faris ka thënë në *Mekajisul-Lugah*: “Nefes është çdo gjë që të lehtëson diçka që të mundon.”

Shejkh Muhamed Ibn Salih el-‘Uthejmin *rahimehullah* ka thënë në *el-Kana'idul-Muthla fii Sifatilabi ue Esma'ihil-Husna*: “Pra, kuptimi i hadithit është se Allahu do ta lehtësojë barrën e besimtarëve nëpërmjet njerëzve të Jemenit.”

Shejkhul-Islam Ibn Tejmije ka thënë në *Mexhmû'ul-Fetava* (6/398): “Ata (njerëzit e Jemenit) ishin që luftuan felëshuesit dhe pushtuan mjaft territore. Pra, nëpërmjet tyre Rrahmani (i Gjithëmëshirëshmi) e lehtësoi barrën e besimtarëve.”

Allahu i Lartësuar i ka bekuar dhe i ka nderuar tokat e Jemenit dhe i ka dhënë këtij vendi një pozitë të veçantë që nuk e gëzon asnjë vend tjetër (me përjashtim të Mekës dhe Medines). Në shumë hadithe janë përmendur vlerat e Jemenit dhe njerëzve që jetojnë aty. Gjithashtu ky vend ka qenë atdheu i shumë Pejgamberëve, Sahabëve, ulemave dhe eulijave të Allahut.

Është transmetuar nga Imam Bukhari dhe Imam Muslimi nga Ebu Hurejra se Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “Njerëzit e Jemenit kanë ardhur. Ata janë tepër të ndjeshëm dhe zemërbutë. Imani është Jemenas dhe Hikmeja (Urtësia) poashtu është Jemenase. Qetësia (Sekine) është cilësi e barinjve të deleve. Ndërsa kryelartësia dhe fodullëku janë cilësi të barinjve të deveve andej nga vendi ku lind dielli.”

Gjithashtu, nga Ebu Hurejra (*radij-Allahu 'anhu*) transmetohet se i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “Juve ju kanë ardhur njerëzit e Jemenit. Ata janë zemërbutë dhe me shpirt mjaft të ndjeshëm. Fik'hu (të kuptuarit) është Jemenas dhe poashtu Hikmeja (urtësia) është e Jemenasve.”⁴⁴

Nga Ebi Mes'udi transmetohet se i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) bëri me shenjë drejt Jemenit dhe tha: “Imani është atje.”⁴⁵

Imam Neueui ka thënë në *Sherh Sahih Muslim*: “Nuk ka asgjë të gabuar në atribuimin e këtyre haditheve në mënyrë konkrete njerëzve të Jemenit. Ata kishin Iman të fortë në kohën e të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe ai e kuptoi këtë gjë nga njerëz të tillë si Ebu Muslim el-Khaulani, Uveys

⁴³ Ky hadith është transmetuar nga Imam Ahmed i Musnedin e tij (n. 10978) nën autoritetin e Ebu Hurejrës (*radij-Allahu 'anhu*).

⁴⁴ *Sahihul-Bukhari* (n. 4129) dhe *Sahihul-Muslim* (n. 84).

⁴⁵ *Sahihul-Bukhari* (n. 4126) dhe *Sahihul-Muslim* (n. 81).

el-Karni dhe delegacionet që vinin tek ai nga Jemeni. Kështu që, fakti që Imani i është atribuar Jemenit do të thotë se njerëzit e Jemenit kishin Iman të plotë e të fortë, por kjo nuk e mohon faktin që ka patur edhe njerëz të tjerë me Iman të fortë poashtu. Sa i përket Fik'hut dhe Hikmes: e para (Fik'hu) do të thotë të kesh një kuptim të thellë të Fesë, ndërsa e dyta (Hikmeh) ka për qëllim el-Ma'rifeh (të jesh i ndërgjegjshëm për Allahun e Lartësuar, me përmirësimin e vetvetes, me moral të mirë dhe duke qëndruar larg pasimit të epsheve dhe gjërave të kota e të pavërtetë). Kuptimi i pjesës “*Ata janë tepër të ndjeshëm dhe zemërbutë*” është se ata janë njerëz të ndrojtur, të turpshëm (*khashijeh*) dhe kanë sjellje plot përulësi e modesti (*istikaneh*). Ata e pranojnë menjëherë këshillën dhe preken menjëherë nga ajo. Ata janë të pastër nga cilësi të tilla si ashpërsia, zemërgurësia dhe vrazhdësia.”⁴⁶

Zejd bin Thabit (*radij-Allahu ‘anhu*) ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) hodhi shikimin kah Jemeni dhe tha: “O Allah! Ktheji zemrat e tyre (në Iman)!”

Nën autoritetin e Ebu Hurejrës (*radij-Allahu ‘anhu*) se i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “...besa është në fisin Ezd.”⁴⁷ [d.m.th. në Jemen]

Xhubejr Ibn Mu'tim (*radij-Allahu ‘anhu*) ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) vështroi retë e pastaj tha: “Juve ju kanë ardhur njerëzit e Jemenit si retë. Ata janë njerëzit më të mirë në fagen e dheut.” Një nga Shokët e tij e pyeti: “O i Dërguari i Allahut! A janë ata më të mirë se ne?” I Dërguari i Allahut u përgjigj: “Përveç jush.”⁴⁸

Nga ‘Amr bin ‘Abese (*radij-Allahu ‘anhu*) i cili tregon se ‘Uejne bin Hisn el-Fezari njëherë tha në prani të të Dërguarit të Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) se: “...njerëzit më të mirë janë ata të Nexhdit.” Ai (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) ia ktheu: “Gënjeve! Njerëzit më të mirë janë ata të Jemenit. Imani është Jemenas dhe unë jam gjithashtu Jemenas.”⁴⁹ Arsyeja përse i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) tha që është Jemenas është - dhe Allahu e di më së miri - për shkak të origjinës së tij Kahtanije, ndërkohë që Kahtani ishte babai i Arabëve dhe ishte nga bijtë e Pejgamberit Isma'il (*‘alejhis-selam*). Kështu që, i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) kishte njëfarë lidhjeje me Jemenasit. Gjithashtu,

⁴⁶ Imam Neueui në *el-Minbaxh Sherh Sahih Muslim*, fq. 158-159.

⁴⁷ *Sunen et-Tirmidhi* (n. 3936).

⁴⁸ *Musned Imam Ahmed* dhe *Musned Ebi Ja'la*.

⁴⁹ Transmetuar nga Taberani dhe Ahmedî dhe të gjithë transmetuesit në zinxhir janë *thikat* (të besueshëm).

mundet që ai (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) të ketë patur për qëllim pëlqimin e karakterit dhe virtyteve të Jemenasve, prandaj ai tha që është “Jemenas” duke lënë të kuptohet se ai kishte të përbashkët me ta karakterin dhe virtytet e tyre. Sido që të jetë, fakti që i Dërguari i Allahut e quajti veten e tij Jemenas tregon se virtyti i këtyre njerëzve nuk mund të nënvlerësohet.

Në një hadith tjetër, Imam Bukhari ka transmetuar se Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “O Allah na beko në Shamin tonë dhe na beko në Jemenin tonë.” Ai e tha këtë tri herë dhe në secilën herë njerëzit e Nexhdit i thonin: “Edhe në Nexhdin tonë, o i Dërguari i Allahut!” Ai tha: “Atje do të ndodhin tërmete dhe fitne dhe atje do të shfaqet briri i Shejtanit.”⁵⁰

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “Imani është i Jemenasve dhe ata janë prej meje dhe drejtimi i tyre është kah unë, ndonëse ata janë në një distancë të largët nga unë. Shumë shpejt ata do t’ju vijnë si Ensarë (ndihmësa) prandaj unë ju urdhëroj që të silleni mirë me ta.”⁵¹

Hadithet që flasin për virtytet dhe mirësinë e Jemenasve janë të shumta në numër dhe është e pamundur që të përmenden të gjitha përnjëherësh këtu. Çdokush që i lexon ato i lind dëshira që të udhëtojë drejt Jemenit për t’i vizituar ensarët e Fesë që ndodhen atje. Vërtet, tokat e Jemenit sot janë kthyer në një fortesë të Sunetit. Jemeni sot është djepi i dijes së pastër Sheriatike.

Shejkh Muhamed bin ‘Abdul-Uehab el-Bena, Allahu e ruajt, ka thënë: “Pasha Allahun, tokat më të preferuara dhe më të mrekullueshme në të gjithë botën sot që po lulëzojnë me zbatimin e Dautit Selefij, me dije dhe mësimdhënie, gjenden tek populli i Jemenit.”

⁵⁰ Nexhdi i përmendur në këtë hadith nuk ka për qëllim Arabinë Saudite, siç mendojnë disa njerëz me përkatësi sektare, të cilët përpiqen të hedhin baltë mbi këtë shtet të bekuar, por këtu bëhet fjalë për Irakun. Këtë shpjegim e kanë dhënë dijetarët e hershëm, të tillë si Ibn Haxher el-Askalani, en-Neueui, Bedrud-Din el-‘Ajni, el-Khattabi etj. Ata janë bazuar në hadithet e tjerë që kanë ardhur nga Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ku përmendet qartazi se Nexhdi ku do të plasnin fitnet dhe do të shfaqet briri i Shejtanit është në lindje të Medines, e që konkretisht bëhet fjalë për Irakun e sotëm. Si për shembull, hadithi i Ibn ‘Umerit (*radij-Allahu ‘anhu*) ku Pejgamberi (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) ka thënë: “O Allah na beko Medinen tonë, na beko Meken tonë, na beko Shamin tonë, na beko Jemenin tonë dhe na beko sa’in dhe muddin tonë (njësitë matëse në tregëti).” Një person i tha: “O i Dërguari i Allahut, edhe Irakun tonë.” Ai iu kthye e i tha: “Atje do të ndodhin tërmete dhe fitne dhe prej andej do të shfaqet briri i Shejtanit.” Transmetuar nga Ebu Nu’ajmi në *el-Hiljetul-Eulija* (6/133) dhe Shu’ajb Arnauti e ka deklaruar zinxhirin e tij *Sahih*.

⁵¹ Transmetuar nga Taberani me një zinxhir të mirë transmetimi.

Epilog:



Vërtet, vdekja e Shejkh Mukbilit është një fatkeqësi që pllakosi Umetin e Muslimanëve në një kohë kur fitnet po shtoheshin dhe grupet e *bidatit* dhe *dalaletit* filluan të lulëzonin menjëherë pas vdekjes së tre Imamëve të pazëvendësueshëm të kësaj Feje: Imam Albani, Imam Ibni Bazi dhe Imam Ibnul-'Uthejmini, Allahu i mëshiroftë që të gjithë ata. Zinxhirit të tyre iu shtua edhe një luftëtar i paepur i Fesë së Allahut i cili me fjalët dhe bojën e tij sqaroi të vërtetën nga e kota dhe i poshtëroi njerëzit e përçarjes dhe lajthitjes. Ishte ai i cili e përhapí Selefizmin në të gjithë Jemenin në një kohë kur ai ishte shkretuar nga Shi'izmi në pjesën veriore të tij dhe sufizmi në jugun e tij. Ndërsa sot Jemeni vezullon nga Da'ueti Selefij dhe numri i pasuesve të Sunetit është shtuar në mënyrë marramendëse.

Allahu e pranoftë Shejkh Mukbilin në Mëshirën dhe Kënaqësinë e Tij dhe e bashkoftë atë me shoqërinë e njerëzve më të zgjedhur: me Pejgamberët, Sahabët, Shehidët dhe të Devotshmit.

Ne i lutemi Allahut '*Azzê ue Xhel* që t'i ruajë Ulematë tanë e ta vazhdojë mirësinë e tyre dhe t'i shtojë njerëzit e drejtë e të përkushtuar që do ta marrin përsipër këtë Dauet të bekuar. I lutemi Allahut '*Azzê ue Xhel* që të nxjerrë thirrësa të singertë e të palëkundur për trojet Shqiptare, në mënyrë që errësira e Shirkut, Kufrit, Bestytnive, Bidateve, Injorancës dhe Hizbijes të çirret nga drita e Teuhidit, Imanit, Sunetit, Dijes së Pastër Sheriatike dhe Unitetit të Zemrave në Fjalën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (*sal-LAllahu 'alejhi ue sel-lem*) sipas metodologjisë së Selefëve. Thirrësa të tillë si Shejkh Mukbili. Amin!

Vërtet, sa shumë e ndjejmë mungesën e thirrësave të tillë në vendin tonë!

© Selefí.org

Përgatiti: Alban Malaj

Fier më 17 Dhjetor 2008 / 18 Dhul-Hixheh 1429

سبحانك اللهم وبحمدك
أشهد أن لا إله إلا أنت
أستغفرك وأتوب إليك

Për këtë biografi janë shfrytëzuar informacione nga disa faqe të ndryshme:

troid.org, al-ibaaanah.com, al-athariyyah.com, SalafiPublications.com,
alatharee.multiply.com, musamills.wordpress.com, abooimraanbooksreviews.blogspot.com